

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI I EDUKIMIT**

**PROGRAMI: MASTER I MËSIMDHËNIES LËNDORE ME SPECIALIZIM  
NË TEKNOLOGJI DHE TIK**



**TEZA MASTER**

**Perceptimet e mësimeve dhe nxënësve për përdorimin e  
platformave online**

**Mentori:**

Prof.Ass.Dr. Florent Bunjaku

**Kandidati:**

Fejzullah Berisha

Prishtinë, Tetor 2021



© 2021 – *Fezullah Berisha* Të gjitha të drejtat të rezervuara.

## ABSTRAKTI

Ky hulumtim fokusohet në perceptimet e mësimit dhe nxënësve gjatë përdorimit të platformave elektronike (online) në edukim, pastaj përparësitë, mangësitë dhe ndikimi i tyre tek nxënësit e nivelit të mesëm të lartë shkollor në komunën e Drenasit, gjatë periudhës së pandemisë të quajtur COVID-19.

Pra, për shkak të gjendjes aktuale me COVID-19, u bë i domosdoshëm përdorimi i platformave online në procesin mësimor dhe mësimit filluan menjëherë, që të nxisin nxënësit në mësim dhe të marrin pjesë në procesin e rregullt mësimor përmes mësimit digjital dhe duke përdorur metoda e teknika të ndryshme, të cilat do t'i stimulojnë nxënësit dhe të kenë mundësinë e qasjes në procesin mësimor në situata të ndryshme.

Përdorimi i platformave elektronike janë shumë të suksesshme në krijimin e një shoqërie virtuale bashkëpunuese për të ndarë informacionet në mënyrë interaktive. Përdorimi i tyre në procesin mësimor u mundëson mësimit të krijojnë klasat, kurset, vendosjen e literaturës, vendosjen e videove mësimore, dërgimin e detyrave, vlerësimin e nxënësve, paraqitjen e rezultateve, orarin mësimor, etj.

Në këtë hulumtim kemi përdorur metodën sasiore dhe cilësore përmes teknikës së anketimit, ku si instrumente matëse janë pyetësi për nxënës dhe intervista për mësimit e Gjymnazit “Gjergj Kastrioti- Skënderbeu” në komunën e Drenasit. Objekt i studimit janë pesë klasë të njëmbëdhjeta me gjithsej 125 nxënës dhe 5 mësimit të lëndëve të ndryshme profesionale, për të marrë mendimin e tyre rreth përdorimit të platformave elektronike (online) gjatë procesit të realizuar mësimor.

Nga hulumtimi kemi nxjerr rezultate pozitive në përdorimin e platformave elektronike (online) gjatë realizimit të mësimit nga distanca. Në hipotezën e parë të ngritur, shumica e nxënësve kanë thënë se përdorimi i platformave elektronike e nxitë interesimin e nxënësve në mësim ndërsa në hipotezën e dytë të ngritur, nxënësit kanë mendime të ndryshme se me përdorimin e platformave elektronike arrijnë rezultate më të mira të të nxënësve. Të dy hipotezat e ngritura i kemi testuar në programin SPSS, hipoteza e parë H1 është vërtetuar dhe pranuar ndërsa hipoteza e dytë H2 është refuzuar.

Nga rezultatet e nxjerra mund të konkludojmë se përdorimi i platformave elektronike ka nxitur nxënësit në mësim, gjë që ka ndikuar në përmirësimin e njohurive dhe shkathtësive të tyre kompjuterike dhe tek disa nxënës në arritjen e rezultateve më të mira të të nxënësve.

**Fjalët kyçe:** Platformat online, procesi mësimor, mësimi digjital, mësimit, nxënësit.

## ABSTRACT

This research focuses on the teachers and students perceptions when using electronic (online) platforms in education, then their advantages, disadvantages and their impact on high school students in the municipality of Drenas, during the period of the pandemic COVID-19.

So, due to the current situation with COVID-19, it became necessary to use online platforms in the learning process and teachers immediately started to encourage students to learn and participate in the regular learning process through digital learning and using different methods and techniques, which would stimulate students and have the opportunity to access the learning process in different situations.

The use of electronic platforms is very successful in creating a virtual collaborative society to share information interactively. Their use in the teaching process enables teachers to create classes, courses, sharing the literature, and teaching materials such as videos, giving assignments, assessment of students, presentation of results, teaching schedule, etc.

In this research we have used the quantitative and qualitative method through the survey technique, where as a measuring instrument are the questionnaire for students and interviews for teachers of the Gymnasium "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu" in the municipality of Drenas. The objects of the study are five eleventh grades, with a total of 125 students and 5 teachers of different professional subjects, in order to get their opinion about the use of electronic (online) platforms during the learning process.

The research has reached positive results in the use of electronic (online) platforms while applying the distance learning. In the first hypothesis, most students said that the use of electronic platforms stimulates students' interest in learning while in the second hypothesis; students have different opinions that by using electronic platforms they achieve better results in learning. Both hypotheses were tested by using the SPSS program, first hypothesis H1 was proved and accepted while the second hypothesis H2 was rejected.

From the reached results, we can conclude that the use of electronic platforms has stimulated students in studying and learning, which has improved their knowledge and computer skills and for some students has impacted in better learning results.

**Keywords:** online platforms, learning process, digital learning, teachers, students.

## FALËNDERIMI

Në radhë të parë falënderoj familjen time për mbështetjen e tyre në çdo aspekt dhe gjithë kolegët për bashkëpunimin dhe përkrahjen e tyre gjatë studimeve.

Falënderime të veçanta kam për mentorin tim Prof.Ass.Dr. Florent Bunjaku për kontributin dhe mbështetjen e tij gjatë studimeve, e çmoj shumë për durimin që pati për diskutimet, këshillat dhe rekomandimet që m'i dha për ta përfunduar tezën e masterit.

Një falënderim të posaçëm kam edhe për profesorin dhe kryetarin e komisionit Prof.Asoc.Dr. Kastriot Buza, për këshillat dhe sugjerimet e tij dhe kontributin që dha në lëminë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit pastaj falënderoj anëtarin e komisionit Prof.Ass.Dr. Teuta Danuza për këshillat dhe sugjerimet e saj.

Do jem mirënjohës për të gjithë profesorët e departamentit të TIK-ut në fakultetin e Edukimit, që me profesionalizimin dhe kontributin e tyre ndikuan në zhvillimin tim profesional.

## PËRMBAJTJA

ABSTRAKTI .....	ii
ABSTRACT.....	iii
FALËNDERIMI .....	iv
Lista e tabelave .....	vii
Lista e figurave .....	viii
Lista e grafikëve.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Lista e shkurtesave.....	viii
1. HYRJE.....	1
1.1. Qëllimi i hulumtimit.....	2
1.2. Pyetjet e hulumtimit .....	2
1.3. Hipotezat e hulumtimit.....	2
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS .....	3
2.1. Platformat elektronike dhe përdorimi i tyre në edukim .....	6
2.2. Platforma Zomm .....	6
2.2.1. Përparësitë dhe mangësitë e platformës Zoom .....	8
2.3. Platforma Schoology .....	8
2.3.1. Përparësitë dhe mangësitë e platformës Schoology.....	11
2.4. Platforma Polleverywhere .....	12
2.4.1. Përparësitë dhe mangësitë e platformës Polleverywhere.....	13
2.5. Platforma Kahoot .....	13
2.5.1. Përparësitë dhe mangësitë e platformës Kahoot .....	15
2.6. Platforma Edmodo.....	15
2.6.1. Përparësitë dhe mangësitë e platformës Edmodo .....	16
3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT .....	18
3.1. Mostra.....	18
3.2. Instrumentet.....	19
3.3. Procedurat.....	19
4. ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET .....	20
4.1. Rezultatet nga pyetësi me nxënës .....	21
4.2. Rezultatet nga intervista me mësimdhënësit .....	36
4.3. Analiza e të dhënave cilësore .....	45
4.4. Testimi i hipotezave .....	48

5. DISKUTIMI DHE KONKLUDIMET .....	51
6. REKOMANDIMET .....	55
REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE .....	56
SHTOJCA A: PYETËSORI PËR NXËNËS .....	58
SHTOJCA B: INTERVISTA PËR MËSIMDHËNËS .....	61
SHTOJCA C: TESTIMI I HIPOTEZAVE NË PROGRAMIN SPSS .....	62



## Lista e tabelave

Tabela 1. Karakteristikat përshkruese të mostrës apo pjesëmarrësve .....	18
Tabela 2. Shpërndarja e mostrës sipas nivelit shkollor dhe gjinisë .....	18
Tabela 3. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve .....	21
Tabela 4. Testi statistikor .....	21
Tabela 5. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve .....	22
Tabela 6. Testi statistikor .....	22
Tabela 7. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve .....	23
Tabela 8. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve .....	24
Tabela 9. Testi statistikor .....	24
Tabela 10. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve .....	25
Tabela 9. Testi statistikor .....	25
Tabela 12. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve .....	26
Tabela 13. Testi statistikor .....	26
Tabela 14. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve .....	27
Tabela 15. Testi statistikor .....	27
Tabela 16. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve .....	28
Tabela 17. Testi statistikor .....	28
Tabela 18. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve .....	29
Tabela 19. Testi statistikor .....	29
Tabela 20. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve .....	30
Tabela 21. Testi statistikor .....	30
Tabela 22. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve .....	31
Tabela 23. Testi statistikor .....	31
Tabela 24. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve .....	32
Tabela 23. Testi statistikor .....	32
Tabela 26. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve .....	33
Tabela 27. Testi statistikor .....	33
Tabela 28. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve .....	34
Tabela 29. Testi statistikor .....	34
Tabela 30. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve .....	35
Tabela 31. Testi statistikor .....	35
Tabela 3. Statistika përshkruese .....	48

Tabela 4. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve .....	48
Tabela 5. Testi statistikor.....	48
Tabela 6. Statistika përshkruese.....	49
Tabela 7. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve .....	49
Tabela 8. Testi statistikor.....	49

## Lista e figurave

Figura 1. Platforma Zoom.....	7
Figura 2. Platforma Schoology .....	9
Figura 3. Platforma Polleverywhere .....	12
Figura 4. Platforma Kahoot.....	14
Figura 5. Platforma Edmodo.....	15
Figura 6. Databaza e të anketuarve për testimin e hipotezave.....	63
Figura 7. Rezultatet nga testimi i hipotezave me testin Hi-Katror .....	64

## Lista e shkurtesave

<b>TIK</b>	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
<b>LMS</b>	Learning Management System
<b>ECDL</b>	European Computer Driving Licence
<b>SHML</b>	Shkolla Mesme e Lartë
<b>SPSS</b>	Statistical Package for the Social Sciences
<b>H</b>	Hipoteza
<b>N</b>	Ndryshorja, Numri i të anketuarve
<b>Sig</b>	Signifikanta
<b>df</b>	Degrees of Freedom (Shkallet e lirisë)
<b>F</b>	Femër
<b>M</b>	Mashkull
<b>V</b>	Vitet

## 1. HYRJE

Viteve të fundit bota po përballet me një virus të rrezikshëm siç është COVID-19, i cili ndryshoi rrjedhën e jetës si dhe veprimtaritë e ndryshme të njeriut. Përveç shëndetësisë ky virus ndikoi pothuajse në të gjitha fushat, e sidomos në arsim. Prandaj u paraqit nevoja për mësimin digjital, i cili u bë i mundur përmes përdorimit të platformave elektronike apo online, në mënyrë që nxënësit të mos mbesin mbrapa në mësim dhe të mos largohet interesi për mësim.

Mësimdhënësit brenda një periudhe të shkurtër, u angazhuan të gjejnë mënyra të ndryshme duke përdorur platformat online, që t'i mbajnë nxënësit aktivë dhe t'i angazhojnë në mësim dhe aktivitete të ndryshme. Prandaj për të mos u shkëputur nga procesi mësimor, digjitalizimi i shkollave u bë i domosdoshëm. Sistemi i arsimit në Kosovë, si në të gjithë botën mori masa parandaluese, dhe mënyra e vetme e zhvillimit të mësimin ishte përdorimi i platformave online, gjë e cila lehtësoi procesin e mbarëvajtjes së mësimin.

Futja e teknologjisë në procesin mësimor është me të vërtetë e rëndësishme pasi plotëson nevojat e nxënësve bashkëkohorë. Ambienti i klasës, sot, është krejtësisht i ndryshëm nga klasa tradicionale. Komponenti teknologjik i të mësuarit po rritet vazhdimisht. Kjo shpesh u ofron nxënësve përvojë më tërheqëse dhe motivuese.

Sikurse mësimi tradicional po ashtu edhe mësimi digjital ka përparësitë dhe dobësitë e veta. Një ndër përparësitë e përdorimit të platformave elektronike në procesin mësimor është mundësia që komunikim mësimdhënës-nxënës të bëhet në çdo kohë, pra eliminohet kufizimi hapësinor dhe kohor. Ndërsa si mangësi mund të përmendim pamundësinë e funksionimit, apo zbatimin e mësimin në praktikë, ose zhvillimi i mësimin në punë ekipore.

Kjo mënyrë e re e punës për një numër të mësimdhënësve, sidomos te ata më të shtyer në moshë ishte një sfidë shumë e madhe sidomos kur kemi parasysh nivelin e tyre të njohurive nga teknologjia, si dhe të mundësive që ofron kjo e fundit në procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Prandaj jo të gjithë mësimdhënësit kanë pasur njohuri për krijimin e platformave online, për të zhvilluar mësimin online. Po ashtu edhe nxënësit kanë pasur problem për tu kyçur në këto platforma si Zoom, etj. Për këtë arsye kam trajtuar këtë temë, në mënyrë që të identifikohen përparësitë dhe mangësitë e platformave online.

Duke pasur parasysh gjendjen e jashtëzakonshme me pandeminë COVID-19, është bërë i domosdoshëm përdorimi i platformave online, prandaj komuna e Drenasit ka filluar t'i përdor këto platforma për të realizuar mësimin elektronik dhe për të bashkëpunuar mësimdhënësit dhe nxënësit gjatë procesit mësimor nga distanca, duke bërë më të lehtë punën e nxënësve gjatë kohës së pandemisë.

Objekt i hulumtimit është përdorimi i platformave elektronike-online gjatë procesit të realizuar mësimor pastaj ndikimi i tyre tek nxënësit dhe vështirësitë gjatë përdorimit të këtyre platformave duke pasur parasysh sfidat e ndryshme që kanë hasur mësimdhënësit dhe nxënësit.

### **1.1. Qëllimi i hulumtimit**

Hulumtimi ka për qëllim përdorimin e platformave elektronike (online) në edukim dhe ndikimin e tyre në procesin mësimor, për të ofruar një formë tjetër të mësimit dhe bashkëpunimit mësimdhënës-nxënës nëpërmjet internetit duke përdorur shërbimet elektronike dhe duke lehtësuar punën e nxënësve gjatë kohës së pandemisë të quajtur COVID-19, për t'i motivuar nxënësit që të jenë aktivë dhe kreativë, në mënyrë që nxënësit të mos largohen nga procesi i rregullt mësimor.

### **1.2. Pyetjet e hulumtimit**

Pyetjet e hulumtimit kanë rëndësi thelbësore për projektin dhe i japin hulumtimit kahjen e shqyrtimeve. (Bob Matthews, 2010)

Për t'i arritur qëllimet e hulumtimit kemi parashtruar disa pyetje dhe hipoteza, të cilave u kemi dhënë përgjigje sipas rezultateve të arritura nga institucioni shkollor.

Pyetjet e hulumtimit janë:

1. Cilat platforma elektronike janë duke u përdorur gjatë procesit mësimor?
2. A kanë vështirësi mësimdhënësit dhe nxënësit gjatë përdorimit të platformave elektronike?
3. A e nxitë interesimin e nxënësve në mësim përdorimi i platformave elektronike?
4. A arrijnë rezultate më të mira nxënësit me përdorimin e platformave elektronike?

### **1.3. Hipotezat e hulumtimit**

Hipotezat për këtë hulumtim janë:

- H1. Përdorimi i platformave elektronike e nxitë interesimin e nxënësve në mësim.
- H2. Nxënësit me përdorimin e platformave elektronike arrijnë rezultate më të mira në mësim.

## 2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Hulumtimet e bëra në disa shkolla të huaja kanë treguar qartë se dijet e nxënësve që kanë përdorur teknologjinë informative apo platformat elektronike në lëndët mësimore kanë qenë të një niveli shumë më të lartë se niveli tek shkollat, që nuk kishin përdorur teknologjinë në procesin mësimor. (Glenn Finger, 2012)

Disa prej autorëve që kanë studiuar përdorimin e platformave elektronike, i kemi paraqitur në vijim:

Përdorimi i platformave elektronike janë shumë të suksesshme në krijimin e një shoqërie virtuale bashkëpunuese për të ndarë informacionet në mënyrë interaktive, ku u mundëson mësimdhënësve të krijojnë klasat, kurset, vendosjen e literaturës, vendosjen e videove mësimore, dërgimin e detyrave, integrimin e kuizeve dhe testeve të ndryshme, vlerësimin e nxënësve, paraqitjen e rezultateve, orarin mësimor, etj. (Nicole Tavares, 2012)

Platformat elektronike mund të nxisin motivimin e nxënësve dhe mund të përmirësojnë rezultatet e nxënësve gjatë përdorimit të tyre në procesin mësimor dhe lehtësojnë qasjen dhe pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve nga distanca duke poseduar internetin dhe një kompjuter apo smartfonë. (Henry, 2011)

Platformat elektronike janë ideale për të angazhuar nxënësit në pasurimin e përmbajtjes së kursit por mund të stimuloj dhe inkurajoj nxënësit të marrin pjesë në proceset e të mësuarit bashkëpunues. (Poungtong Udomsil, 2016)

Integrimi dhe aplikimi i TIK-ut në mësimdhënie, ofron përfitime të mëdha për nxënësit dhe rritë aftësitë konceptuese dhe perceptuese të tyre gjatë orës së mësimi duke lehtësuar të nxënësit, aftësitë funksionale të lexim-shkrimit digjital, pastaj duke nxitë dhe zhvilluar te nxënësit një sërë aftësish të tjera, të tilla si aftësi matematikore, aftësi komunikuese, aftësi të të menduarit kritik dhe të zgjidhjes së problemeve, aftësi për të punuar në grup, aftësi për të përdorur shumëllojshmëri burimesh e instrumentesh, etj. (Mexhuani, 2014)

Përdorimi i aplikacioneve në internet nga ana e mësimdhënësve dhe nxënësve promovon mjedisin e mësimi në klasë dhe aktivitetet e të nxënësit sepse integrimi i aplikacioneve në internet dhe Sistemi i Menaxhimit të Mësimi (LMS) i ndihmon mësimdhënësit dhe nxënësit të kenë shërbime arsimore gjithëpërfshirëse për të promovuar arsimin dhe mësimin dhe për të arritur qëllimet e tyre. (Aljraiwi, 2017)

Përdorimi i platformës Google Forms u mundëson mësimdhënësve përpilimin e testeve dhe kuizeve në formë elektronike për vlerësimin e nxënësve në mënyrë automatike dhe paraqitjen e menjëhershme të rezultateve. Kjo është një mundësi e mirë që nxënësit të qëndrojnë larg nga

çdo tension, stres dhe ankth që mund të shkaktohet nga atmosfera në klasë gjatë testimit në formë fizike. (Ali, 2018)

Mësimi elektronik (e-mësimi) është proces i të mësuarit nga bashkëveprimi me përmbajtjen e dhënë në mënyrë digjitale duke përdorur pajisjet teknologjike si, kompjuterët, smartfonët dhe tabletët qoftë nga distanca ose në klasë, për t'u zhvendosur nga mësimi tradicional në mësim virtual të personalizuar, fleksibël, individual, të vetë-organizuar dhe bashkëpunues me mësimdhënësit dhe nxënësit, etj. (Jethro, 2012)

Schoology është një sistem i menaxhimit të të mësuarit falas, që mund të përdoret për të krijuar një mjedis interaktiv në internet për nxënësit. Brenda platformës Schoology, nxënësit mund të punojnë dhe të paraqesin detyra, të marrin përshtypje dhe të bashkëpunojnë me bashkëmohatarë etj. Është mjeti më i shpejtë në marrjen e vlerësimeve dhe vlerësimin automatik, kështu që e bën kohën e mësimdhënësve më të efektshme për të dhënë detyra, komente ose reflektim. Sigurisht, është më e efektshme se sa detyra tradicionale që duhet të shkruhet në një letër, dhe gjithashtu ndihmon mësimdhënësin në mbledhjen, kursimin e të dhënave dhe vlerësimin. (Karlin & Ozogul, 2016)

Përdorimi i platformës Kahoot, e cila mundëson krijimin e kuizeve, ka potencialin për të përmirësuar rezultatet e nxënësve në procesin mësimor gjithashtu krijon një ambient argëtues dhe tërheqës dhe emocional për nxënësit dhe motivon ata të mësojnë. Përdorimi i kuizeve në formë të lojërave në mjedisin e klasës është treguar të jetë një mjet pedagogjik efektiv për të përmirësuar performancën e nxënësve. (Darren Iwamoto, 2017)

Përdorimi i platformës Google Forms u mundëson mësimdhënësve përpilimin e testeve dhe kuizeve në formë elektronike për vlerësimin e nxënësve në mënyrë automatike dhe paraqitjen e menjëhershme të rezultateve. Kjo është një mundësi e mirë që nxënësit të qëndrojnë larg nga çdo tension, stres dhe ankth që mund të shkaktohet nga atmosfera në klasë gjatë testimit në formë fizike. (Ali, 2018)

Zbatimi i mësimin nëpërmjet interaktivitetit mund të ndihmojë zhvillimin e aftësive shoqërore të nxënësit, ku çdo nxënës apo anëtar i grupit mund të përfshihet në procesin mësimor duke mundësuar krijimin e raporteve pozitive dhe ndërveprimin në mes tyre dhe në mes mësimdhënësve dhe nxënësve, në mënyrë që procesi mësimor të jetë më efektiv dhe më atraktiv apo tërheqës. (Hanum, 2016)

Platformat elektronike shërbejnë si një mjet i shkëlqyeshëm për sistemin arsimor, të cilat lehtësojnë punën e mësimdhënësit për vlerësimin e nxënësve për të gjitha lëndët mësimore dhe për të gjitha aktivitetet e realizuara në procesin mësimor. (Boachie, 2016)

Përdorimi i web aplikacioneve në edukim lehtësojnë organizimin e orës mësimore dhe mundësojnë interaktivitet mes mësimdhënësve dhe nxënësve duke i motivuar nxënësit që përmes pamjeve vizuale dhe simulimeve të ndryshme, të arrijnë rezultate më të mira të të nxënësve. (Fateme S. Lari, 2014)

Përdorimi i TIK-ut ndikon në krijimin e mundësive të reja për nxënësit dhe mësimdhënësit për t'u angazhuar në mënyra të reja të të nxënësve për të gjithë duke integruar në mënyrë efektive teknologjinë e informimit e të komunikimit, duke forcuar dhe përshtatur përdorimin në sektorin e arsimit për të përmirësuar përfshirjen dhe qëllimet e barazisë dhe duke i kushtuar vëmendjen e duhur zhvillimit të kurrikulave të arsimit. (MASHT, 2011)

Mësimi në distancë mundëson të shfrytëzohet të nxënësve nëpërmjet zgjidhjes së problemeve, i cili paraqet një mjet të fuqishëm që nxit të menduarit kreativ dhe krijues tek nxënësit. Krijimi i një mjedisi virtual ku nxënësit hulumtojnë dhe angazhohen në një sërë strategjish për zgjidhjen e problemeve i aftëson ata të eksplorojnë alternativat dhe të zhvillojnë vetëbesimin e tyre për të mësuar. (MASHT, 2020)

Sipas raporteve të drejtorive komunale të arsimit, numri i mësimdhënësve dhe shkollave të përfshira në mësimin elektronik, për të zhvilluar aktivitete online me nxënësit e tyre, po rritet nga dita në ditë, gjë që do të ndikoj pozitivisht në motivimin e nxënësve, që të mësojnë dhe për të lehtësuar punën e tyre gjatë kohës së pandemisë. (MASHT, 2020)

Krahasimi midis mësimin tradicional dhe mësimin digjital (McKiernan, 2011), vuri në dukje karakteristika të ndryshme në përmbajtjen e materialit mësimor, kanalet e të mësuarit dhe metodat e praktikës midis mësimin tradicional dhe mësimin digjital. Për shembull, përmbajtja e të mësuarit që përqendrohet në lehtësi dhe fleksibilitet, ishin të përshtatshme për nxënësit, Megjithëse mësimi digjital nuk mund të zëvendësojë plotësisht mësimin tradicional, ai mund të arrijë efektin më të mirë mësimor dhe nxënësit të jenë të lumtur të mësojnë duke forcuar mënyrën e të mësuarit siç është mësimin digjital dhe praktikimi gjithëpërfshirës i të dy metodave në veprimtaritë mësimore. (Hung, 2017)

Mësimi tradicional ishte më i mirë për kurset që kërkonin funksionim praktik ose punë ekipore. Mangësi tjetër e përdorimit të platformave online në mësim është mundësia e kopjimit nga libri apo nga ndonjë mjet tjetër elektronik nga ana e nxënësve. Gjithashtu mësimi digjital i pamundëson mësimdhënësit të përmisoi dhe të korigjoi nxënësit në mënyrë të ndërsjellë si me shkrim po ashtu edhe gjatë të folurit. Mangësi tjetër, e kjo në veçanti në vendin tonë, mund të konsiderohet ndërprerja e rrymës apo mos funksionimi i rrjetit, si nga ana e mësimdhënësit po ashtu edhe nga ana e nxënësve.

## 2.1. Platformat elektronike dhe përdorimi i tyre në edukim

Me zhvillimin e World Wide Web dhe shfletuesit të internetit vazhduan të krijohen edhe platformat elektronike për të mundësuar zhvillimin e mësimit digjital.

Mësimi digjital (E-Learning) u propozua për herë të parë nga Jay Kross në vitin 1999. Me përparimin dhe zhvillimin e mjeteve të teknologjisë, u shfaqën mundësi dhe terminologji të ndryshme, të tilla si trajnime të bazuara në internet, mësimi online ose mësimi në distancë. Sipas (West, 2002) teknologjia e digjitalizuar ka hedhur rrugën përpara për të mundësuar hyrjen në informacione dhe shpërndarjen e fundit të përmbajtjeve të mësimit digjital, se mësimi digjital angazhon, fuqizon dhe mbështet të mësuarit në atë mënyrë që transformon rrënjësisht mekanizmin e kërkimit të njohurive për nxënës. Përdorimi i përditshëm i mediave të reja digjitale ndikon në mënyrën e komunikimit dhe të të mësuarit, pasi që në mënyrë aktive dhe krijuese ndërton njohuri dhe promovon "kulturën mediatike pjesëmarrëse" (Ito et. Al, 2010). Sipas (Thielemann, dhe Chen 2008) shumica e mësimitdhënësve mbajnë perceptimin e përgjithshëm se kompjuterët dhe përdorimi i platformave elektronike kanë përmirësuar klimën për të mësuar, veçanërisht duke rritur motivimin e nxënësve.

Platformat elektronike dhe përdorimi i tyre në edukim promovon mjedisin e mësimit në klasë dhe aktivitetet e të nxënësve sepse integrimi i tyre në procesin mësimor i ndihmon mësimitdhënësit dhe nxënësit të kenë shërbime arsimore gjithëpërfshirëse për të promovuar arsimin dhe mësimin dhe për të arritur qëllimet e tyre. (Aljraiwi, 2017)

Zbatimi i mësimit nëpërmjet interaktivitetit mund të ndihmojë zhvillimin e aftësive shoqërore të nxënësit, ku çdo nxënës apo anëtar i grupit mund të përfshihet në procesin mësimor duke mundësuar krijimin e raporteve pozitive dhe ndërveprimin në mes tyre dhe në mes mësimitdhënësve dhe nxënësve, në mënyrë që procesi mësimor të jetë më efektiv dhe më atraktiv apo më tërheqës. (Hanum, 2016)

Disa nga platformat elektronike të cilat mund të përdoren online në procesin mësimdhënës dhe nxënës janë: Zoom, Schoology, Polleverywhere, Kahoot, Edmodo, etj. Në vijim do t'i paraqesim këto platforma gjithashtu përparësitë dhe mangësitë e tyre.

## 2.2. Platforma Zoom

Zoom është një platformë komunikimi mësimitdhënës-nxënës që përdoret në mësimin virtual për të ndihmuar mësimitdhënësit të qëndrojnë në kontakt me nxënësit e tyre duke komunikuar "ballë për ballë" në mënyrë që ata të marrin atë ndjenjën e të qenit në klasë me mësimitdhënësit dhe bashkëmoshatarët e tyre.



Platforma elektronike Zoom ka ndihmuar në futjen e një numri risish në mësimin e lëndëve dhe gjuhëve të huaja. Përdorimi i gjerë i metodave, aktiviteteve dhe mjeteve mësimore me asistencë kompjuterike u mundësoi mësimdhënësve në gjithë botën të përmirësojnë mësimdhënien e tyre dhe të maksimizojnë mundësitë e të mësuarit për nxënësit e tyre. Për fat të mirë, shumë shkolla të mesme nga njëra anë dhe familjet nga ana tjetër posedojnë pajisje kompjuterike dhe qasje në internet për të bërë të mundur të mësuarit përmes teknologjisë.

Në mënyrë tipike, ekzistojnë dy grupe mësimdhënësish të interesuar për të eksperimentuar me mësimdhënien në internet: ata që po mendojnë të përdorin kurse të mëimit në distancë për nxënësit që nuk mund të ndjekin mësimet dhe ata që kërkojnë të plotësojnë mësimin në klasë me komponente më interaktive në internet. (Guzacheva, 2020)

Mjetet online të mëimit në distancë po ndryshojnë botën në të cilën jetojmë dhe mënyrën se si të mësojmë. Një nga zgjidhjet e reja dhe më të mira për realizimin e mëimit është teknologjia Zoom. Zoom është një shërbim i bazuar në cloud që ofron takime dhe seminare dhe ofron ndarjen e përmbajtjes dhe mundësinë për video konferenca. Ndhmon mësimdhënësit të sjellin nxënësit e tyre së bashku në një mjedis për të punuar dhe mësuar më shumë.




Figura 1. Platforma Zoom

Zoom është lider në komunikimet e ndërmarrjeve, me një platformë të lehtë dhe të besueshme për konferenca, video dhe audio, bashkëpunim, biseda dhe seminare për pajisjet mobile, desktopët, laptopët, etj. Karakteristikat e platformës Zoom lejojnë mësimdhënësit të eksplorojnë dhe vlerësojnë aftësitë përmes ndërveprimeve me nxënës gjatë procesit të realizuar mësimor dhe duke ndarë informacionet së bashku. Mësimdhënësit mund të incizojnë mësimet

e tyre në cloud ose në nivel lokal gjithashtu edhe nxënësit mund të incizojnë dhe aktivizojnë sa herë që ata dëshirojnë gjatë mësimet, nëse mësimdhënësi e mundëson këtë veçori.

Mësimdhënësit mund të incizojnë mësimet dhe t'i shikojnë përsëri për të vlerësuar pikat e forta dhe të dobëta të nxënësve dhe nxënësit mund të vetëvlerësojnë aftësitë e tyre duke parë mësimet e regjistruara. Nxënësit mund të shikojnë mësimet e regjistruara në një sekuencë për të parë përmirësimin e tyre me kalimin e kohës. Përveç kësaj, mësimdhënësit mund të vlerësojnë zhvillimin e nxënësve duke i treguar mësimin e regjistruar një mësimdhënësi tjetër, të cilit ata i besojnë, dhe duke kërkuar reagime konstruktive.

Zoom u jep mundësinë mësimdhënësve të paraqesin përmbajtjen e mësimëve të tyre në mënyra të ndryshme. Ndarja e ekranit të Zoom mund t'u japë mësimdhënësve një mundësi të shkëlqyeshme për të zhvilluar aftësitë ndërkulturore të nxënësve duke ndarë materiale tërheqëse si video, artikuj dhe prezantime. Gjatë mësimëve dhe pas shikimit të tyre, mësimdhënësit mund të inkurajojnë nxënësit që të parashtrojnë pyetje për të analizuar dhe vlerësuar të mësuarit e tyre. Mësimdhënësit gjithashtu mund t'u kërkojnë nxënësve të reflektojnë në mësimet e tyre duke regjistruar një video dhe duke e shpërndarë atë.

### **2.2.1. Përparësitë dhe mangësitë e platformës Zoom**

Përparësitë e platformës Schoology janë:

- Është falas,
- E lehtë për tu përdorur,
- Ofron cilësi të videos dhe audios,
- Mbështet deri në 100 pjesëmarrës,
- Ndërveprimi mes mësimdhënësve dhe nxënësve,
- Mundëson incizimin e mësimëve.

Mangësitë e platformës Schoology janë:

- Kërkon internet të shpejtë,
- Komunikimi mund të zgjas deri në 40 minuta,
- Nuk është shumë i sigurt,

### **2.3. Platforma Schoology**

Schoology është një platformë elektronike apo sistem i menaxhimit të të mësuarit në internet (LMS) që u mundëson mësimdhënësve të organizojnë mësimin, kurrikulën, të krijojnë plane mësimore dhe të bëjnë vlerësimin e nxënësve. Schoology është një sistem revolucionar i

menaxhimit të të mësuarit dhe mjet i rrjeteve sociale që lejon përdoruesit të krijojnë dhe shpërndajnë projektet e tyre akademike. Gjatë procesit të të mësuarit online përmes platformës Schoology mësimit mund të zgjedhë module të ndryshme për mësim, siç është krijimi i një mësimi interaktiv, i cili mund të jetë i lehtë dhe i arritshëm për nxënësit për të mësuar kudo dhe në çdo kohë. Që do të thotë se, nuk është e domosdoshme ndjekja e mësimit në objekte fizike shkollare sepse procesi i mësimit mund të zbatohet duke përdorur një sistem në internet, ku mësimit dhe nxënësit mund të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin dhe të vazhdojnë të diskutimin e tyre sikur në klasë. (Cummins, 2007)




Figura 2. Platforma Schoology

Schoology ka karakteristika të fuqishme për të gjitha nevojat e arsimtarëve dhe institucioneve akademike për të siguruar që nxënësit të vazhdojnë të mësojnë në çdo kohë dhe kudo. Shërbimet e platformës Schoology përfshijnë regjistrime të pjesëmarrjes, ditar elektronik, teste dhe kuize, postime për detyrat e shtëpisë, etj. Integrimi i mediave sociale lehtëson bashkëpunimin brenda një klase, grupi ose një shkolle të tërë. Sistemi mund të integrohet me sistemet ekzistuese të raportimit dhe informacionit shkollor dhe ofron siguri, filtra dhe mbështetje të cilat mund të përdoren në mënyrë aktive. Platforma zakonisht u ofrohet individëve dhe shkollave falas. (Wauters, 2010)

Si karakteristikë tjetër e platformës Schoology është se mund të ketë qasje në aplikacione të tjera në internet si Google Drive dhe Google Docs. Çdo klasë ose kurs paraqitet në panelin e

kursit si dhe nën skedën e kurseve. Skeda e grupeve lejon nxënësit të kenë qasje në klube, aktivitete, ngjarje, etj. Secili nxënës dhe mësimitdhënës ka një profil në Schoology, ata mund të lidhen së bashku, gjë që lejon kalimin midis llogarive pa pasur nevojë të identifikohen veç e veç. Përdoruesit gjithashtu mund të ndajnë kalendarin e tyre Schoology, duke lejuar shërbime të tjera të kalendarit të tilla si Outlook dhe Google Calendar të kenë qasje në ngjarjet nga Schoology duke përdorur një lidhje iCal. (Katie, 2017)

Platforma Schoology përmban module të ndryshme të cilat mund të përdoren me lehtësi nga mësimitdhënësit dhe të zhvillojnë mësimet e tyre në mënyrë efikase nga modulet të cilat ofrojnë interaktivitet mes mësimitdhënësve dhe nxënësve.

Modulet e platformës Schoology janë :

- Shtimin e materialeve (Materials),
- Përditësimet/Njoftimet (Updates),
- Notimi (Grades),
- Shenjat (Badges),
- Pjesëmarrja (Attendance),
- Pjesëmarrësit (Members),
- Diskutimet (Discussions),
- Caktimi & Dorëzimi detyrave (Assignments),
- Teste & Kuize; (Test&Quizess),
- Grupet ( Groups),
- Burimet (Resources),
- Kalendari (Calendars),
- Video Konferencat (Video Conferencing),
- Tabela online (Blackboard).

Mësimitdhënësit përmes platformës Schoology mund të krijojnë faqe private në lidhje me edukimin. Koncepti themelor i Schoology është profesional dhe akademik dhe, me këto dy karakteristika mësimitdhënësit mund të ndajnë burimet, të postojnë praktikat më të mira dhe të ndërtojnë një komunitet të të mësuarit në internet. Schoology u ofron shumë mundësi mësimitdhënësve që ta përdorin platformën në mënyrë shumë efikase.

Platforma Schoology u lejon nxënësve të kenë një forum për të diskutuar koncepte akademike, për të ndarë njohuritë dhe për të përdorur mjetet Web 2.0 për qëllime mësimore. Megjithëse pikëpamja e nxënësve nuk i lejon mësimitdhënësit të censurojnë çdo koment, ekspozimi ndaj

pikëpamjeve të nxënësve të tjerë do të ishte i dobishëm për nxënësit e rinj derisa përgatiten për shkollën e mesme dhe të gjitha pritjet shoqërore që së shpejti do të hasin.

Është e rëndësishme që mësimitdhënësit të kenë kohë për të përcjellë qartë pritjet e nxënësve siç do të bënin me çdo burim tjetër që përdorin nxënësit. Schoology ofron një lidhje private për të parë përditësimet e nxënësve çdo ditë. Gjithashtu kjo platformë u lehtëson punën prindërve duke i mundësuar atyre që të jenë të informuar për statusin e fëmijëve të tyre. Për shembull mësimitdhënësit mund të postojnë datat e parashkrimit, detajet e detyrave, burimet ku përmes këtyre, prindërit janë të informuar se çfarë detyra kanë për të bërë fëmijët dhe kështu duke shfrytëzuar burimet e dërguara nga mësimitdhënësi ata mund t'u ndihmojnë fëmijëve në shtëpi.

### **2.3.1. Përparësitë dhe mangësitë e platformës Schoology**

Përparësitë e platformës Schoology janë:

- Është falas,
- Qasje e lehtë,
- Ngjashmëria me faqet kryesore të rrjeteve sociale siguron lehtësinë e përdorimit,
- Siguron mjete dhe burime efikase për mësimitdhënësit,
- Ofron interaktivitet nxënës – nxënës, mësimitdhënësi – nxënës,
- Burime të ndryshme edukativo – arsimore,
- Nxënësit mund të marrin pjesë në diskutime, detyra dhe kuize,
- Nxënësit mund të dërgojnë mesazhe sikur në e-mail,
- Mësimitdhënësi ka një ditar për nota,
- Mësimitdhënësi mund të shohë statistikën dhe notat,
- Mësimitdhënësit mund të printojnë direkt listën e pjesëmarrjes së nxënësve.

Mangësitë e platformës Schoology janë:

- Nxënësit mund të largohen nga fokusi kryesor arsimor dhe të shpërqendrohen,
- Asnjë llogari nuk mund të hapet në të njëjtën kohë në një kompjuter,
- Stilet dhe preferencat e të mësuarit nuk përfshihen kur krijoni profilin e nxënësit,
- Nxënësve u duhet kodi i klasës për t'u regjistruar,
- Kodet për qasje të nxënësve janë shumë të gjata,
- Vështirë për të lundruar në faqet e pyetjeve dhe pjesëmarrjes,
- Kërkon shumë kohë për të mësuar sistemin.

## 2.4. Platforma Polleverywhere

Polleverywhere është një platformë dinamike në internet që mundëson krijimin e pyetjeve të hapura, pyetjeve me shumë zgjedhje dhe sondazheve dhe i lejon nxënësit të përgjigjen përmes kompjuterëve, smartfonëve apo tabletëve. Mund të sjellë më shumë ndërveprim në klasë për të angazhuar më tej nxënësit në përvojën e të mësuarit. Mësimdhënësit mund të gjenerojnë lehtësisht pyetjet për t'i vendosur individualisht ose si një seri pyetjesh.




Figura 3. Platforma Polleverywhere

Nxënësit mund të përgjigjen duke ndjekur udhëzimet e paraqitura në platformë kur pyetjet shfaqen. Ata mund të përgjigjen duke dërguar një mesazh me tekst në numrin e dhënë atyre në ekran ose mësimdhënësit mund të marrin dhe të ndajnë një link të personalizuar me nxënësit për t'u përgjigjur në internet ose përmes aplikacionit në android. Mësimdhënësit mund të vendosin preferencat për secilin aktivitet se si ata duan të lejojnë dërgimin e përgjigjeve.

Platforma Polleverywhere mund të përdoret si një strategji e vlerësimit formues që rrit dhe plotëson diskutimin, pjesëmarrjen dhe mirëkuptimin në klasë.

Nxënësit zakonisht nuk mund të përqendrohen në material pasiv për më shumë se 15 minuta, kështu që dhënia e mundësisë së nxënësve për të ndarë mësimin pasiv në një mësim aktiv mund të përqendrojë vëmendjen e tyre.

Disa nga mënyrat që mund të përdoret kjo platformë përfshinë: për të mbledhur të dhëna, të vlerësojë menjëherë kuptimin e koncepteve, për të sfiduar perceptimet ose keqkuptimet, për kuize dhe teste të drejtpërdrejta në klasë, për sondazhe, etj.

Në teknikën stuhi mendimesh apo brainstorming, e cila realizohet përmes pyetjeve të parashtruara nga mësimdhënësi në formë verbale dhe duke u përgjigjur nxënësit në mënyrë të njëjtë. Atëherë platforma Polleverywhere mund të përdoret në formë interaktive gjatë fazës së evokimit dhe të zgjas 5-10 minuta, ku mësimdhënësi mund t'i krijoj pyetjet e hapura dhe nxënësit të përgjigjen përmes kompjuterit ose telefonit.

#### **2.4.1. Përparësitë dhe mangësitë e platformës Polleverywhere**

Përparësitë e platformës Polleverywhere janë:

- Lejon nxënësit të kontribuojnë më lirshëm sesa në një diskutim normal në klasë duke mbetur anonim (nxënësit shpesh përdorin pseudonimet e tyre),
- Inkurajon të mësuarit aktiv - të gjithë nxënësit inkurajohen të marrin pjesë,
- Mësimdhënësit mund japin reagime mbi përparimin e nxënësve në një kurs, duke i lejuar ata të adresojnë më mirë nevojat dhe shqetësimet e tyre.

Mangësitë e platformës Polleverywhere janë:

- Përgjigjet janë të kufizuara deri në 40 nxënës apo përdorues.
- Nuk i identifikon pjesëmarrësit nëse nuk kërkohet nga ata të identifikojnë veten e tyre.
- Përgjigjet janë rezultate të disponueshme vetëm përmes një skedari .csv, i cili mund të integrohet në programin Excel.

#### **2.5. Platforma Kahoot**

Platforma Kahoot mundëson krijimin e kuizeve dhe ka potencialin për të përmirësuar rezultatet e nxënësve gjithashtu krijojnë një ambient argëtues dhe tërheqës dhe emocional për nxënësit dhe i motivon ata të mësojnë më shumë. Kjo platformë mund të përdoret në teknikën stuhi mendimesh gjatë fazës së evokimit dhe si lloj kuizi në fazën e reflektimit.

Kahoot lejon mësimdhënësit të përdorin përmbajtjen e kursit për të ndërtuar kuize në të cilat nxënësit marrin pjesë si lojtarë në një "lojë-shfaqje" dhe duke bërë vlerësimin e tyre. Për shembull, mësimdhënësit mund të përdorin lehtësisht Kahoot për të përpiluar pyetjet e kuizit ku nxënësit mund të përgjigjen duke përdorur një shfletues uebi në pajisjet e tyre digjitale. Kuizet mund të përmirësohen me imazhe dhe video, dhe mësimdhënësi është në gjendje të kontrollojë ritmin e lojës. Nxënësve u jepen pikë për përgjigje të saktë në pyetjet e kuizit dhe afatet kohore të përgjigjeve të sakta gjithashtu ndikojnë në pikët e fituara. Shfaqja e pikëve në ekran i motivon nxënësit të cilët arrijnë në majën e bordit drejtues.



Figura 4. Platforma Kahoot

Kahoot nxit motivimin dhe angazhimin e nxënësve dhe përmirëson dinamikën e klasës pasi sistemi u ofron nxënësve reagime në kohë reale të performancës së tyre, dhe në një farë mase përshtat aktivitetet mësimore bazuar në përgjigjet e nxënësve në kuize. Përveç kësaj, Kahoot përfshin media sociale, u mundëson nxënësve të krijojnë, ndajnë dhe shkëmbejnë përmbajtje me të tjerët në klasë, dhe kështu, nxit një ndjenjë të komunitetit (Wang 2015). Më tej, kufizimet në kohë janë minimale, Kahoot i mbledh dhe i grumbullon përgjigjet individuale të pyetjeve brenda pak minutash. Prandaj, mësimmësuesit mund të përqendrohen në hartimin e pyetjeve, administrimin e kuizit dhe më pas, në lehtësimin e diskutimit në lidhje me përgjigjet (jo) të sakta. (Licorish, 2018)

Në të vërtetë, Kahoot ka një ndikim më të madh në ndërveprimet ndër personale sesa platformat tjera, duke lejuar që konkurrenca dhe diskutimi të ndodhin midis një klase të tërë sesa në grupe të vogla dhe për këtë arsye nuk ka gjasa të shkaktojë mërzitje. Megjithëse konceptet komplekse në materialin e kursit mund të rrisin zhgënjimin e nxënësve gjatë përdorimit të Kahoot, këto përvoja nuk ka gjasa të vazhdojnë për një periudhë të gjatë kohore. Prandaj, Kahoot është zgjidhja mbi të cilën do të eksploronim mënyrën se si mjetet e tilla ndikojnë në motivimin, angazhimin dhe mësimin e nxënësve. Sidoqoftë, pavarësisht provave të forta se Kahoot rrit vëmendjen, motivimin dhe angazhimin e nxënësve, mbetet e paqartë nëse Kahoot çon në rezultate më të mira të nxënësve sesa metodat tradicionale.



### 2.5.1. Përparësitë dhe mangësitë e platformës Kahoot

Përparësitë platformës Kahoot janë:

- Kahoot është falas për shkollat dhe institucionet e tjera arsimore.
- Paraqitje e thjeshtë, e qartë dhe shumë e lehtë për tu përgjigjur nga nxënësit.
- Muzikë tërheqëse dhe e lehtë për tu vendosur në imazhe.
- Rezultatet përfshijnë emra dhe janë të disponueshëm përmes spreadsheets në Excel. Këto lexohen lehtë dhe përfshijnë shumë informacione.

Mangësitë platformës Kahoot janë:

- Ofron vetëm një alternativë për tu përgjigjur në kuiz, në versionin pa pagesë.
- Në total, ka vetëm katër lloje pyetjesh, dhe dy janë shumë të ngjashme.

### 2.6. Platforma Edmodo

Edmodo është një platforme për komunikim akademik, funksionon përmes sistemeve efektive të menaxhimit të përmbajtjes dhe mësimit të integruar (Cheong, 2010). Edmodo është falas dhe i sigurt, dhe ofron shërbime për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit. Ai siguron një mënyrë të sigurt dhe të lehtë për përdoruesit që të lidhen, të bashkëpunojnë, të shkëmbejnë ide dhe të ndajnë përmbajtje edukative.




Figura 5. Platforma Edmodo

Mësimdhënësit mund të përdorin llogaritë e tyre në internet për të ofruar mësim për nxënësit. Rrjeti Edmodo ofron tre lloje të llogarive (për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit), dhe secili grup aktorësh përkatës përdor rrjetin për të përmbushur nevojat e tij. Ky rrjet lejon përdorimin e të ashtuquajturës klasë, një model mësimor që ka për qëllim të përdorë sa më mirë teknologjinë përmes internetit. Duke përdorur këtë model, mësimdhënësit planifikojnë mësim për nxënësit që përfshijnë skedarë video dhe audio, si dhe burime të tjera.

Në platformën Edmodo nxënësit mund t'i shikojnë materialet dhe të mësojnë në shtëpi (ose kudo tjetër) përmes kompjuterit, smartfonit ose tabletit, ata më pas ndjekin kursin dhe përfshihen në diskutime, projekte dhe trajnime. Rrjeti Edmodo ka më shumë se 100 milion përdorues aktivë nga rreth 400,000 shkolla në 140 vende, rreth 90 milionë mësimdhënës kanë ndarë mbi 700 milionë burime. (Alqahtani, 2019)

Tomassini (2013) e përshkroi Edmodo si një faqe interneti falas që është e lehtë për t'u përdorur. Edmodo ka ndihmuar nxënësit dhe edukatorët të kryejnë funksione të tilla si krijimi i detyrave, rishikimi i punimeve dhe materialet mësimore. Edmodo i lejon nxënësit të kapërcejnë kufizimet e shkaktuara nga distanca dhe koha dhe mund të marrin pjesë në procesin mësimor nga vende të ndryshme. Edmodo gjithashtu ndihmon për të mbyllur boshllëqet midis nxënësve në lidhje me qasjen e tyre në arsim, duke përmirësuar kështu rezultatet e të nxënësve.

### **2.6.1. Përparësitë dhe mangësitë e platformës Edmodo**

Përparësitë e platformës Edmodo janë:

- Është falas dhe e lehtë për t'u përdorur,
- Është një rrjet i mbyllur dhe shumë i sigurt,
- Mësimdhënësit mund të krijojnë lidhje me nxënës të tjerë nga shkolla, vende ose kultura të ndryshme,
- Ofron një mori burimesh të komunitetit dhe lidhjet që mësimdhënësit mund t'i bëjnë me mësimdhënësit e tjerë,
- Mësimdhënësit mund ta dallojnë të mësuarit duke krijuar nëngrupe të nxënësve
- Nxënësit mund të përfundojnë detyrat e shtëpisë, të marrin kuize, sondazhe dhe të vlerësohen me nota dhe të marrin reagime nga mësimdhënësit,
- Prindërit mund të përfshihen duke parë punën dhe notat e fëmijëve të tyre dhe duke mbajtur kontakte me mësimdhënësit,
- Ofron një metodë për ndarjen e dokumenteve dhe mediave digjitale në internet,
- Mjet i shkëlqyeshëm për t'u përdorur edhe në pajisjet mobile.

Mangësitë platformës Edmodo janë:

- Mesazhet me tekst nuk janë një veçori e disponueshme,
- Ndërfaqja është më shumë e drejtuar drejt nxënësve dhe edukatorëve kundrejt biznesit.
- Nëse nxënësit nuk kanë qasje në kompjuter dhe internet, ose në një pajisje të lëvizshme, ata nuk do të jenë në gjendje të përdorin platformën,
- Nuk ka ndërveprim ballë për ballë,
- Vonesat në përgjigjet e reagimeve nga bashkëmoshatarët ose mësuesit.

### 3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Në këtë hulumtim kemi përdorur metodën sasiore dhe cilësore për shkak të natyrës së të dhënave të mbledhura me anë të pyetësores dhe intervistës në gërshetim të ndërsjellë me literaturën akademike.

#### 3.1. Mostra

Metoda e zgjedhjes së kampionit që është përdorur në këtë hulumtim është kampioni joprobabilitar (i qëllimshëm), me anën e të cilit janë treguar përfaqësuesit e të gjithë mësimdhënësve dhe nxënësve në shkollën e mesme të lartë të komunës së Drenasit.

Në këtë hulumtim grupin reprezentativ do ta përbëjnë nxënësit e shkollave të mesme të larta të komunës së Drenasit. Duke pas parasysh numrin e nxënësve dhe numrin e shkollave të mesme në këtë komunë, kemi përzgjedhur shkollën e mesme të larta të mjedisit urban, Gjinnazin “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” në Drenas, i cili përbën një numër të madh të nxënësve të kësaj komune dhe duke pas parasysh faktin që punoj në këtë shkollë, hulumtimi do të ishte në interes të shkollës edhe për mua si mësimdhënës.

Objekt i studimit do të jenë pesë klasë të njëmbëdhjeta me gjithsej 125 nxënës, dhe 5 mësimdhënës të lëndëve të ndryshme profesionale.

Tabela 1. Karakteristikat përshkruese të mostrës apo pjesëmarrësve

Institucioni shkollor	Nxënës	Gjinia		Mosha	Klasat				
	N	F	M	V	XI <sub>1</sub>	XI <sub>2</sub>	XI <sub>3</sub>	XI <sub>4</sub>	XI <sub>5</sub>
Gjinnazi “Gjergj Kastrioti -Skënderbeu”	125	72	53	16/17	25	24	26	24	26
Gjithsej	<b>125</b>	<b>72</b>	<b>53</b>	<b>16/17</b>	<b>25</b>	<b>24</b>	<b>26</b>	<b>24</b>	<b>26</b>

Tabela 2. Shpërndarja e mostrës sipas nivelit shkollor dhe gjinisë

Niveli shkollor	Nxënës	Femër	Mashkull
Klasa XI <sub>1</sub>	25	15	10
Klasa XI <sub>2</sub>	24	16	8
Klasa XI <sub>3</sub>	26	9	17
Klasa XI <sub>4</sub>	24	18	6
Klasa XI <sub>5</sub>	26	14	12
Gjithsej	<b>125</b>	<b>72</b>	<b>53</b>

### **3.2. Instrumentet**

Në këtë hulumtim kemi përdorur teknikën e anketimit dhe si instrumente kryesore matëse janë: pyetësi për nxënës dhe intervista për mësime, të cilat janë përpiluar për të mbledhur informacione rreth përdorimit të platformave online dhe për vështirësitë e përdorimit të tyre gjatë procesit të realizuar mësime.

Pra, përmes këtyre instrumenteve matëse do të vëzhgojmë dhe argumentojmë situatën aktuale dhe vështirësitë që paraqiten në procesin e mësimit dhe mësimit gjatë përdorimit të të mësuarit digjital dhe përdorimin fleksibël të mjeteve të teknologjisë. Për mbledhjen e informacioneve të mjaftueshme për hulumtim, kemi hartuar pyetësit për nxënës dhe intervistat për mësime.

### **3.3. Procedurat**

Në fazën e parë kam biseduar me drejtorin e shkollës së përzgjedhur dhe pas miratimit nga ana e tij kam filluar aplikimin me qëllim të realizimit sa më të suksesshëm të këtij hulumtimi.

Në fazën e dytë të këtij hulumtimi i kam njoftuar me kohë nxënësit dhe mësime dhe i kam shpërndarë pyetësit në klasat e përzgjedhura për hulumtim, ku përmes pyetësorëve dhe intervistës kemi marr një vlerësim nga ana e nxënësve dhe e mësimeve për përdorimin e të mësuarit digjital dhe përdorimin fleksibël të mjeteve të teknologjisë.

Në fazën e tretë kam bërë analizimin e të dhënave të grumbulluara përmes pyetësorëve dhe intervistave të mësimeve, pastaj kam bërë sistemimin i përgjigjeve me programin Microsoft Excel dhe rezultatet e fituara i kam paraqitur në mënyrë tabelare dhe grafike ndërsa testimin dhe vërtetimin e hipotezave e kam bërë me programin aplikativ SPSS.

## 4. ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET

Sipas hulumtimit të realizuar, kemi nxjerr rezultate rreth perceptimit të mësimdhënësve dhe nxënësve gjatë përdorimit të platformave online, pastaj përparësitë dhe mangësitë e tyre dhe vështirësitë me të cilat përballen mësimdhënësit dhe nxënësit gjatë përdorimit të platformave elektronike (online). Pra, nga ky hulumtim kemi marr rezultate pozitive rreth aktivizimit të nxënësve dhe bashkëpunimit të tyre në mësim pastaj nxitjen e interaktivitetit mes tyre, kështu duke përfituar dhe përvetësuar njohuritë dhe shkathhtësitë e tyre dhe duke arritur rezultate më të mira të të nxënësve.

Për këtë hulumtim kemi përzgjedhur shkollën e mesme të lartë Gjinnazin “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu”, me numrin më të madh të nxënësve në qytetin e Drenasit.

Analizën e të dhënave e kemi bërë me programin SPSS dhe me testin Chi-square apo testin Hi-katror. Testi Hi-Katror është një test që përdoret dhe që zgjidhet shpesh për shkak të lehtësisë së aplikimit në hulumtimet statistikore. Varësisht qëllimit dhe situatës, testi Hi-Katror përbëhet nga tri lloje: testi i përshtatshmërisë, testi i pavarësisë dhe testi i homogjenitetit.

Testi Hi-Katror, i cili është një ndër testet që përdoret më së shumti brenda testeve joparametrike, mat përshtatshmërinë e shpërndarjes së vlerave të grupit të mostrës (shpërndarje normale, etj.) me shpërndarjen e popullimit të përcaktuar në hipotezë. Për arsye se kërkohet përshtatshmëria apo pajtueshmëria ndërmjet vlerës së prituar dhe vlerës së përfituar, quhet “testi i përshtatshmërisë”.

Gjatë përcaktimit të hipotezës përcaktohet edhe se çfarë shpërndarje kanë të dhënat. Bëhet krahasimi i vlerës së frekuencës së prituar me vlerën e frekuencës së vrojtuar. Në qoftë se ekziston pajtueshmëri ndërmjet vlerës së prituar me vlerën e vrojtuar, hipoteza pranohet dhe në qoftë se nuk ka pajtueshmëri, atëherë hipoteza refuzohet. (Hamel, 2017)

Në vijim kemi paraqitur rezultatet e hulumtimit rreth pyetësorit me nxënës, intervistës me mësimdhënës dhe vërtetimin e hipotezave, të cilat i kemi testuar përmes programit SPSS.

#### 4.1. Rezultatet nga pyetësi me nxënës

Të dhënat sasiore (statistikore) i kemi grumbulluar përmes anketimeve, në këtë rast përmes pyetësorëve të realizuar me nxënësit e Shkollës së Mesme të Lartë (SHML) Gjinnazi “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu”, në qytetin e Drenasit.

Pyetësorët e realizuar me nxënës i kemi paraqitur dhe interpretuar, si në vijim.

Në pyetjen: *1. Cila është gjinia juaj?*, nxënësit janë përgjigjur si në tabelën 3.

Tabela 3. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve

	<b>Observed N</b> (Vlera e Vëzhguar)	<b>Expected N</b> (Vlera e Pritur)	<b>Residual</b> (Mbetja)
Femër	72	62.5	9.5
Mahkull	53	62.5	-9.5
Total	125		

Tabela 4. Testi statistikor

<b>Chi-Square</b> (Hi-Katror)	<b>df</b> (Shkallet e lirisë)	<b>Asymp. Sig.</b> (Signifikanta Asimptotike)
2.888 <sup>a</sup>	1	.089

Sipas rezultateve në tabelën 3, në pyetjen “*Cila është gjinia juaj?*”, nxënësit nga Gjinnazi “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu”, 72 apo 58% prej tyre i takojnë gjinisë femërore dhe 53 apo 42% i takojnë gjinisë mashkullore.

Nga ky anketim shihet se, numri më i madh i nxënësve i takojnë gjinisë femërore ndërsa vlera e Signifikantes Asimptotike është 0.089 dhe është më e madhe se niveli i rëndësisë që është Sig ( $P < 0.05$ ). Prandaj, nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet vlerave të anketuarve sa i përket gjinisë, kurse vlera e Hi-Katrorit (Chi-Square) është përcaktuar si 2.888.

Në pyetjen: 2. *Cila është moshë juaj?*, nxënësit janë përgjigjur si në tabelën 5.

Tabela 5. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve

	<b>Observed N</b> (Vlera e Vëzhguar)	<b>Expected N</b> (Vlera e Pritur)	<b>Residual</b> (Mbetja)
16 vjeç	103	62.5	40.5
17 vjeç	22	62.5	-40.5
Total	125		

Tabela 6. Testi statistikor

<b>Chi-Square</b> (Hi-Katror)	<b>df</b> (Shkallet e lirisë)	<b>Asymp. Sig.</b> (Signifikanta Asimptotike)
52.488 <sup>a</sup>	1	.000

Sipas rezultateve në tabelën 5, në pyetjen “*Cila është moshë juaj?*”, nxënësit nga Gjimnazi “Gjergj Kastrioti-Skenderbeu”, 103 apo 82% prej tyre i takojnë moshës 16 vjeçare dhe 22 apo 18% i takojnë moshës 17 vjeçare.

Nga ky anketim shihet se, shumica e nxënësve i takojnë moshës 16 vjeçare dhe më pak moshës 17 vjeçare, ndërsa vlera e Signifikantes Asimptotike është 0.000 dhe është më e vogël se niveli i rëndësisë që është Sig ( $P < 0.05$ ). Prandaj, ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet vlerave të anketuarve sa i përket moshës, kurse vlera e Hi-Katrorit (Chi-Square) është përcaktuar si 52.488.



Në pyetjen: 3. *A është shkolla juaj e pajisur me kabinet dhe internet?*, nxënësit janë përgjigjur si në tabelën 7.

Tabela 7. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve

	<b>Observed N</b> (Vlera e Vëzhguar)	<b>Expected N</b> (Vlera e Pritur)	<b>Residual</b> (Mbetja)
Po	125	125	0
Total	125 <sup>a</sup>		

Sipas rezultateve në tabelën 7, në pyetjen “*A është shkolla juaj e pajisur me kabinet dhe internet?*”, nxënësit nga Gjimnazi “Gjergj Kastrioti-Skenderbeu”, 125 apo 100% prej tyre janë përgjigjur për opsionin “Po”, se shkolla e tyre është e pajisur me kabinet dhe internet.

Nga ky anketim shihet se, të gjithë nxënësit janë deklaruar se shkolla e tyre është e pajisur me kabinet dhe internet, ndërsa vlera e Signifikantes Asimptotike nuk paraqitet sepse të gjithë të anketuarit janë përgjigjur në opsionin “Po”, sa i përket pajisjes së shollës së tyre me kabinet dhe internet.

Në pyetjen: 4. A jeni duke i përdorur platformat elektronike-online gjatë procesit mësimor?, nxënësit janë përgjigjur si në tabelën 8.

Tabela 8. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve

	<b>Observed N</b> (Vlera e Vëzhguar)	<b>Expected N</b> (Vlera e Pritur)	<b>Residual</b> (Mbetja)
Po, rregullisht	61	41.7	19.3
Shpeshherë	52	41.7	10.3
Nganjëherë	12	41.7	-29.7
Total	125		

Tabela 9. Testi statistikor

<b>Chi-Square</b> (Hi-Katror)	<b>df</b> (Shkallet e lirisë)	<b>Asymp. Sig.</b> (Signifikanta Asimptotike)
32.656 <sup>a</sup>	2	.000

Sipas rezultateve në tabelën 8, në pyetjen “A jeni duke i përdorur platformat elektronike-online gjatë procesit mësimor?”, nxënësit nga Gjimnazi “Gjergj Kastrioti-Skenderbeu”, 61 apo 49% prej tyre janë përgjigjur për opsionin “Po, rregullisht”, 52 apo 42% për opsionin “Shpeshherë” dhe 12 apo 9% për opsionin “Nganjëherë”.

Nga ky anketim shihet se, shumica e nxënësve gjatë procesit mësimor i kanë përdorur platformat elektronike-online ndërsa vlera e Signifikantes Asimptotike është 0.000 dhe është më e vogël se niveli i rëndësisë që është Sig ( $P < 0.05$ ). Prandaj, ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet vlerave të anketuarve sa i përket përdorimit të platformave elektronike, kurse vlera e Hi-Katrorit (Chi-Square) është përcaktuar si 32.656.

Në pyetjen: 5. *Cilat platforma elektronike jeni duke i përdorur gjatë procesit mësimor?*, nxënësit janë përgjigjur si në tabelën 10.

Tabela 10. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve

	<b>Observed N</b> (Vlera e Vëzhguar)	<b>Expected N</b> (Vlera e Pritur)	<b>Residual</b> (Mbetja)
Zoom	107	69.5	37.5
Edmodo	52	69.5	-17.5
Kahoot	73	69.5	3.5
Google Forms	46	69.5	-23.5
Total	278		

Tabela 11. Testi statistikor

<b>Chi-Square</b> (Hi-Katror)	<b>df</b> (Shkallet e lirisë)	<b>Asymp. Sig.</b> (Signifikanta Asimptotike)
32.763 <sup>a</sup>	3	.000

Sipas rezultateve në tabelën 10, në pyetjen “*Cilat platforma elektronike jeni duke i përdorur gjatë procesit mësimor?*”, nxënësit nga Gjimnazi “Gjergj Kastrioti-Skenderbeu”, 107 apo 85% prej tyre janë përgjigjur për platformën “Zoom”, 73 apo 58% për platformën “Kahoot”, 52 apo 41% për platformën “Edmodo” dhe 46 apo 36% për platformën “Google Forms”.

Nga ky anketim shihet se, nxënësit gjatë procesit mësimor me shumë e kanë përdorur platformën elektronike Zoom dhe Kahoot pastaj Edmodo dhe Google Forms, ndërsa platformat tjera nuk i kanë përdorur, ndërsa vlera e Signifikantes Asimptotike është 0.000 dhe është më e vogël se niveli i rëndësisë që është Sig ( $P < 0.05$ ). Prandaj, ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet vlerave të anketuarve sa i përket përdorimit të platformave elektronike nga ana e nxënësve, kurse vlera e Hi-Katrorit (Chi-Square) është përcaktuar si 32.763.

Në pyetjen: 6. A keni vështirësi gjatë përdorimit të platformave elektronike?, nxënësit janë përgjigjur si në tabelën 12.

Tabela 12. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve

	<b>Observed N</b> (Vlera e Vëzhguar)	<b>Expected N</b> (Vlera e Pritur)	<b>Residual</b> (Mbetja)
Shpeshherë	12	41.7	29.7
Nganjëherë	49	41.7	7.3
Rrallëherë	64	41.7	22.3
Total	125		

Tabela 13. Testi statistikor

<b>Chi-Square</b> (Hi-Katror)	<b>df</b> (Shkallet e lirisë)	<b>Asymp. Sig.</b> (Signifikanta Asimptotike)
34.384 <sup>a</sup>	2	.000

Sipas rezultateve në tabelën 12, në pyetjen “A keni vështirësi gjatë përdorimit të platformave elektronike?”, nxënësit nga Gjimnazi “Gjergj Kastrioti-Skenderbeu”, 64 apo 51% prej tyre janë përgjigjur për opsionin “Rrallëherë”, 49 apo 39% për opsionin “Nganjëherë” dhe 12 apo 10% për opsionin “Shpeshherë”.

Nga ky anketim shihet se, nxënësit gjatë përdorimit të platformave elektronike kanë pasur pak vështirësi, ndërsa vlera e Signifikantes Asimptotike është 0.000 dhe është më e vogël se niveli i rëndësisë që është Sig ( $P < 0.05$ ). Prandaj, ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet vlerave të anketuarve sa i përket vështirësive gjatë përdorimit të platformave elektronike, kurse vlera e Hi-Katrorit (Chi-Square) është përcaktuar si 34.384.

Në pyetjen: 7. *Si ndikon në procesin mësimor përdorimi i platformave elektronike?*, nxënësit janë përgjigjur si në tabelën 14.

Tabela 14. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve

	<b>Observed N</b> (Vlera e Vëzhguar)	<b>Expected N</b> (Vlera e Pritur)	<b>Residual</b> (Mbetja)
Pozitivisht	86	41.7	44.3
Negativisht	7	41.7	-34.7
Nuk ndikon fare	32	41.7	-9.7
Total	125		

Tabela 15. Testi statistikor

<b>Chi-Square</b> (Hi-Katror)	<b>df</b> (Shkallet e lirisë)	<b>Asymp. Sig.</b> (Signifikanta Asimptotike)
78.256 <sup>a</sup>	2	.000

Sipas rezultateve në tabelën 14, në pyetjen “*Si ndikon në procesin mësimor përdorimi i platformave elektronike?*”, nxënësit nga Gjimnazi “Gjergj Kastrioti-Skenderbeu”, 86 apo 69% prej tyre janë përgjigjur për opsionin “Pozitivisht”, 32 apo 26% për opsionin “Nuk ndikon fare” dhe 7 apo 5% për opsionin “Negativisht”.

Nga ky anketim shihet se, përdorimi i platformave elektronike ndikon pozitivisht në procesin mësimor, ndërsa vlera e Signifikantes Asimptotike është 0.000 dhe është më e vogël se niveli i rëndësisë që është Sig ( $P < 0.05$ ). Prandaj, ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet vlerave të anketuarve sa i përket ndikimit gjatë përdorimit të platformave elektronike në procesin mësimor, kurse vlera e Hi-Katrorit (Chi-Square) është përcaktuar si 78.256.

Në pyetjen: 8. *A e nxitë interesimin në mësim përdorimi i platformave elektronike?*, nxënësit janë përgjigjur si në tabelën 16.

Tabela 16. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve

	<b>Observed N</b> (Vlera e Vëzhguar)	<b>Expected N</b> (Vlera e Pritur)	<b>Residual</b> (Mbetja)
Po, e nxitë shumë	39	31.3	7.8
E nxitë mjaft	26	31.3	-5.3
E nxitë disi	43	31.3	11.8
Nuk e nxitë aspak	17	31.3	-14.3
Total	125		

Tabela 17. Testi statistikor

<b>Chi-Square</b> (Hi-Katror)	<b>df</b> (Shkallet e lirisë)	<b>Asymp. Sig.</b> (Signifikanta Asimptotike)
13.720 <sup>a</sup>	3	.003

Sipas rezultateve në tabelën 16, në pyetjen “*A e nxitë interesimin në mësim përdorimi i platformave elektronike?*”, nxënësit nga Gjimnazi “Gjergj Kastrioti-Skenderbeu”, 39 apo 31% prej tyre janë përgjigjur për opsionin “Po, e nxitë shumë”, 26 apo 21% për opsionin “E nxitë mjaft”, 43 apo 34% për opsionin “E nxitë disi” dhe 17 apo 14% për opsionin “Nuk e nxitë aspak”.

Nga ky anketim shihet se, përdorimi i platformave elektronike e nxitë interesimin e nxënësve në mësim, ndërsa vlera e Signifikantes Asimptotike është 0.003 dhe është më e vogël se niveli i rëndësisë që është Sig ( $P < 0.05$ ). Prandaj, ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet vlerave të anketuarve sa i përket nxitjes së nxënësve në mësim përmes përdorimit të platformave elektronike, kurse vlera e Hi-Katrorit (Chi-Square) është përcaktuar si 13.720.

Në pyetjen: 9. *Sa ju ndihmojnë platformat elektronike të bashkëpunoni gjatë procesit mësimor?*, nxënësit janë përgjigjur si në tabelën 18.

Tabela 18. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve

	<b>Observed N</b> (Vlera e Vëzhguar)	<b>Expected N</b> (Vlera e Pritur)	<b>Residual</b> (Mbetja)
Shumë	53	31.3	21.8
Mjaft	28	31.3	-3.3
Disi	32	31.3	8
Aspak	12	31.3	-19.3
Total	125		

Tabela 19. Testi statistikor

<b>Chi-Square</b> (Hi-Katror)	<b>df</b> (Shkallet e lirisë)	<b>Asymp. Sig.</b> (Signifikanta Asimptotike)
27.352 <sup>a</sup>	3	.000

Sipas rezultateve në tabelën 18, në pyetjen “*Sa ju ndihmojnë platformat elektronike të bashkëpunoni gjatë procesit mësimor?*”, nxënësit nga Gjimnazi “Gjergj Kastrioti-Skenderbeu”, 53 apo 42% prej tyre janë përgjigjur për opsionin “Shumë”, 28 apo 22% për opsionin “Mjaft”, 32 apo 26% për opsionin “Disi” dhe 12 apo 10% për opsionin “Aspak”.

Nga ky anketim shihet se, përdorimi i platformave elektronike i ndihmon mjaft nxënësit të bashkëpunojnë gjatë procesit mësimor, ndërsa vlera e Signifikantes Asimptotike është 0.000 dhe është më e vogël se niveli i rëndësisë që është Sig ( $P < 0.05$ ). Prandaj, ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet vlerave të anketuarve sa i përket bashkëpunimit të nxënësve nëpërmjet platformave elektronike, kurse vlera e Hi-Katrorit (Chi-Square) është përcaktuar si 27.352.

Në pyetjen: 10. A ofron interaktivitet mes juve dhe mësimdhënësve përdorimi i platformave elektronike?, nxënësit janë përgjigjur si në tabelën 20.

Tabela 20. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve

	<b>Observed N</b> (Vlera e Vëzhguar)	<b>Expected N</b> (Vlera e Pritur)	<b>Residual</b> (Mbetja)
Po, ofron shumë	38	31.3	6.8
Ofron mjaft	51	31.3	19.8
Ofron disi	29	31.3	-2.3
Nuk ofron aspak	7	31.3	-24.3
Total	125		

Tabela 21. Testi statistikor

<b>Chi-Square</b> (Hi-Katror)	<b>df</b> (Shkallet e lirisë)	<b>Asymp. Sig.</b> (Signifikanta Asimptotike)
32.920 <sup>a</sup>	3	.000

Sipas rezultateve në tabelën 20, në pyetjen “A ofron interaktivitet mes juve dhe mësimdhënësve përdorimi i platformave elektronike?”, nxënësit nga Gjimnazi “Gjergj Kastrioti-Skenderbeu”, 38 apo 30% prej tyre janë përgjigjur për opsionin “Po, ofron shumë”, 51 apo 41% për opsionin “Ofron mjaft”, 29 apo 23% për opsionin “Ofron disi” dhe 7 apo 6% për opsionin “Nuk ofron aspak”.

Nga ky anketim shihet se, se përdorimi i platformave elektronike ofron interaktivitet mes nxënësve dhe mësimdhënësve, ndërsa vlera e Signifikantes Asimptotike është 0.000 dhe është më e vogël se niveli i rëndësisë që është Sig ( $P < 0.05$ ). Prandaj, ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet vlerave të anketuarve sa i përket interaktivitetit përmes përdorimit të platformave elektronike, kurse vlera e Hi-Katrorit (Chi-Square) është përcaktuar si 32.920.



Në pyetjen: 11. Sa ju ndihmon përdorimi i platformave elektronike për t'i përvetësuar më mirë njohuritë dhe shkathtësitë e juaja?, nxënësit janë përgjigjur si në tabelën 22.

Tabela 22. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve

	<b>Observed N</b> (Vlera e Vëzhguar)	<b>Expected N</b> (Vlera e Pritur)	<b>Residual</b> (Mbetja)
Shumë	43	31.3	11.8
Mjaft	35	31.3	3.8
Disi	38	31.3	6.8
Aspak	9	31.3	-22.3
Total	125		

Tabela 23. Testi statistikor

<b>Chi-Square</b> (Hi-Katror)	<b>df</b> (Shkallet e lirisë)	<b>Asymp. Sig.</b> (Signifikanta Asimptotike)
22.168 <sup>a</sup>	3	.000

Sipas rezultateve në tabelën 22, në pyetjen “Sa ju ndihmon përdorimi i platformave elektronike për t'i përvetësuar më mirë njohuritë dhe shkathtësitë e juaja? e juaja?”, nxënësit nga Gjimnazi “Gjergj Kastrioti-Skenderbeu”, 43 apo 35% prej tyre janë përgjigjur për opsionin “Shumë”, 35 apo 28% për opsionin “Mjaft”, 38 apo 30% për opsionin “Disi” dhe 9 apo 7% për opsionin “Aspak”.

Nga ky anketim shihet se, përdorimi i platformave elektronike i ndihmon nxënësit për t'i përvetësuar më mirë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre, ndërsa vlera e Signifikantes Asimptotike është 0.000 dhe është më e vogël se niveli i rëndësisë që është Sig ( $P < 0.05$ ). Prandaj, ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet vlerave të anketuarve sa i përket përdorimit të platformave elektronike për t'i përvetësuar më mirë njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësve, kurse vlera e Hi-Katrorit (Chi-Square) është përcaktuar si 22.168.

Në pyetjen: 12. A arrini rezultate më të mira në mësim me përdorimin e platformave elektronike?, nxënësit janë përgjigjur si në tabelën 24.

Tabela 24. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve

	<b>Observed N</b> (Vlera e Vëzhguar)	<b>Expected N</b> (Vlera e Pritur)	<b>Residual</b> (Mbetja)
Po	35	31.3	3.8
Ndoshta	40	31.3	8.8
Jo	21	31.3	-10.3
Nuk e di	29	31.3	-2.3
Total	125		

Tabela 25. Testi statistikor

<b>Chi-Square</b> (Hi-Katror)	<b>df</b> (Shkallet e lirisë)	<b>Asymp. Sig.</b> (Signifikanta Asimptotike)
6.424 <sup>a</sup>	3	.093

Sipas rezultateve në tabelën 24, në pyetjen “A arrini rezultate më të mira në mësim me përdorimin e platformave elektronike?”, nxënësit nga Gjimnazi “Gjergj Kastrioti-Skenderbeu”, 35 apo 28% prej tyre janë përgjigjur për opsionin “Po”, 40 apo 32% për opsionin “Ndoshta”, 21 apo 17% për opsionin “Jo” dhe 29 apo 23% për opsionin “Nuk e di”.

Nga ky anketim shihet se, me përdorimin e platformave elektronike nxënësit kanë mendime të ndryshme për arritjen e rezultateve më të mira në mësim, ndërsa vlera e Signifikantes Asimptotike është 0.093 dhe është më e madhe se niveli i rëndësisë që është Sig ( $P < 0.05$ ). Prandaj, nuk ekziston ndonjë dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet vlerave të anketuarve sa i përket arritjes së rezultateve më të mira në mësim me përdorimin e platformave elektronike, kurse vlera e Hi-Katrorit (Chi-Square) është përcaktuar si 6.424.

Në pyetjen: 13. *Cilat janë përparësitë e përdorimit të platformave elektronike?*, nxënësit janë përgjigjur si në tabelën 26.

Tabela 26. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve

	<b>Observed N</b> (Vlera e Vëzhguar)	<b>Expected N</b> (Vlera e Pritur)	<b>Residual</b> (Mbetja)
Qasja e lehtë	87	75.0	12.0
Ofrojnë bashkëpunim	69	75.0	-6.0
Mundësojnë reagime	55	75.0	-20.0
Janë atraktive	73	75.0	-2.0
Janë motivuese	91	75.0	16.0
Total	375		

Tabela 27. Testi statistikor

<b>Chi-Square</b> (Hi-Katror)	<b>df</b> (Shkallet e lirisë)	<b>Asymp. Sig.</b> (Signifikanta Asimptotike)
11.200 <sup>a</sup>	4	.024

Sipas rezultateve në tabelën 26, në pyetjen “*Cilat janë përparësitë e përdorimit të platformave elektronike?*”, nxënësit nga Gjimnazi “Gjergj Kastrioti-Skenderbeu”, 87 apo 69% prej tyre janë përgjigjur për opsionin “Qasja e lehtë”, 69 apo 55% për opsionin “Ofrojnë bashkëpunim”, 55 apo 44% për opsionin “Mundësojnë reagime”, 73 apo 58% për opsionin “Janë atraktive” dhe 91 apo 72% për opsionin “Janë motivuese”.

Nga ky anketim shihet se, përparësitë kryesore të përdorimit të platformave elektronike janë qasja e lehtë dhe janë motivuese për nxënësit pastaj ato janë atraktive, ofrojnë bashkëpunim dhe mundësojnë reagime në kohë, ndërsa vlera e Signifikantes Asimptotike është 0.024 dhe është më e vogël se niveli i rëndësisë që është Sig ( $P < 0.05$ ). Prandaj, ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet vlerave të anketuarve sa i përket përparësive të përdorimit të platformave elektronike, kurse vlera e Hi-Katrorit (Chi-Square) është përcaktuar si 11.200.

Në pyetjen: 14. *Cilat janë mangësitë e përdorimit të platformave elektronike?*, nxënësit janë përgjigjur si në tabelën 28.

Tabela 28. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve

	<b>Observed N</b> (Vlera e Vëzhguar)	<b>Expected N</b> (Vlera e Pritur)	<b>Residual</b> (Mbetja)
Nevojitet interneti	109	64.4	44.6
Duhet regjistruar	82	64.4	17.6
Janë të kufizuara	43	64.4	-21.4
Nuk janë të sigurta	61	64.4	-3.4
Janë të komplikuar	27	64.4	-37.4
Total	322		

Tabela 29. Testi statistikor

<b>Chi-Square</b> (Hi-Katror)	<b>df</b> (Shkallet e lirisë)	<b>Asymp. Sig.</b> (Signifikanta Asimptotike)
64.708 <sup>a</sup>	4	.000

Sipas rezultateve në tabelën 28, në pyetjen “*Cilat janë mangësitë e përdorimit të platformave elektronike?*”, nxënësit nga Gjimnazi “Gjergj Kastrioti-Skenderbeu”, 109 apo 87% prej tyre janë përgjigjur për opsionin “Nevojitet interneti”, 82 apo 65% për opsionin “Duhet regjistruar”, 43 apo 34% për opsionin “Janë të kufizuara”, 61 apo 48% për opsionin “Nuk janë të sigurta” dhe 27 apo 21% për opsionin “Janë të komplikuar”.

Nga ky anketim shihet se, mangësitë kryesore të përdorimit të platformave elektronike janë se nevojitet interneti dhe duhet regjistruar nxënësit pastaj ato nuk janë të sigurta, janë të kufizuara dhe janë të komplikuar, ndërsa vlera e Signifikantes Asimptotike është 0.000 dhe është më e vogël se niveli i rëndësisë që është Sig ( $P < 0.05$ ). Prandaj, ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet vlerave të anketuarve sa i përket mangësive të përdorimit të platformave elektronike, kurse vlera e Hi-Katrorit (Chi-Square) është përcaktuar si 64.708.

Në pyetjen: 15. Sa jeni të kënaqur me përdorimin e platformave elektronike?, nxënësit janë përgjigjur si në tabelën 30.

Tabela 30. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve

	<b>Observed N</b> (Vlera e Vëzhguar)	<b>Expected N</b> (Vlera e Pritur)	<b>Residual</b> (Mbetja)
Shumë	39	31.3	7.8
Mjaft	27	31.3	-4.3
Disi	35	31.3	3.8
Aspak	24	31.3	-7.3
Total	125		

Tabela 31. Testi statistikor

<b>Chi-Square</b> (Hi-Katror)	<b>df</b> (Shkallet e lirisë)	<b>Asymp. Sig.</b> (Signifikanta Asimptotike)
4.632 <sup>a</sup>	3	.201

Sipas rezultateve në tabelën 30, në pyetjen “Sa jeni të kënaqur me përdorimin e platformave elektronike?”, nxënësit nga Gjimnazi “Gjergj Kastrioti-Skenderbeu”, 39 apo 31% prej tyre janë përgjigjur për opsionin “Shumë”, 27 apo 22% për opsionin “Mjaft”, 35 apo 28% për opsionin “Disi” dhe 24 apo 19% për opsionin “Aspak”.

Nga ky anketim shihet se, nxënësit janë jashtëzakonisht të kënaqur me përdorimin e platformave elektronike, ndërsa vlera e Signifikantes Asimptotike është 0.201 dhe është më e madhe se niveli i rëndësisë që është Sig ( $P < 0.05$ ). Prandaj, nuk ekziston ndonjë dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet vlerave të anketuarve sa i përket kënaqësisë së nxënësve rreth përdorimit të platformave elektronike, kurse vlera e Hi-Katrorit (Chi-Square) është përcaktuar si 4.632.

## 4.2. Rezultatet nga intervista me mësime dhënësit

Intervistat me mësime dhënësit i kam realizuar në Gjime nazin “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu” në komunën e Drenasit, ku kanë marrë pjesë 5 mësime dhënësit të lëndëve të ndryshme, si TIK, Matematikë, Kimi, Biologji dhe Gjuhë Shqipe.

Intervistat e realizuara me mësime dhënësit, i kemi paraqitur në vijim:

### INTERVISTA 1

**1. Cila është gjinia juaj?**

Mashkull.

**2. Cila është fusha e juaj e mësime dhënies?**

Fusha ime e mësime dhënies është Jeta dhe Puna, lënda TIK.

**3. A është shkolla juaj e pajisur me kabinet dhe internet?**

Po, është e pajisur.

**4. A jeni duke i përdorur platformat elektronike (online) gjatë procesit mësimeor?**

Po, jemi duke i përdorur disa prej tyre.

**5. Cilat platforma elektronike jeni duke i përdorur gjatë procesit mësimeor?**

Zoom, Edmodo dhe Kahoot.

**6. A keni vështirësi gjatë përdorimit të platformave elektronike?**

Jo, por mund të ndodhë ndonjëherë të kemi vështirësi.

**7. Si ndikojnë në procesin mësimeor përdorimi i platformave elektronike?**

Mendoj se të gjitha platformat elektronike ndikojnë pozitivisht në procesin mësimeor.

**8. A e nxitë interesimin e nxënësve në mësime përdorimi i platformave elektronike?**

Sigurisht se përdorimi i platformave elektronike e nxitë interesimin e nxënësve për të mësuar më shumë.

**9. Sa ju ndihmojnë platformat elektronike të bashkëpunoni gjatë procesit mësimeor?**

Gjatë përdorimit të platformave, si Zoom, Edmodo dhe Kahoot, nxënësit kanë qenë më të angazhuar dhe bashkëpunimi ka qenë në nivelin e duhur, kjo për shkak të përdorimit dhe integritimit të teknologjisë në procesin mësimeor.

**10. A ofron interaktivitet mes juve dhe nxënësve përdorimi i platformave elektronike?**

Sigurisht se përdorimi i platformave elektronike ofron interaktivitet mes ne dhe nxënësve sepse i motivon ata për të punuar më shumë.

**11. Sa i ndihmon nxënësit përdorimi i platformave elektronike për t'i përvetësuar më mirë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre?**

Sigurisht se përdorimi i platformave elektronike i ka ndihmuar nxënësit për të punuar dhe mësuar më shumë dhe i ka bërë ata më të përgjegjshëm dhe më të shkathët.

**12. A arrijnë rezultate më të mira nxënësit me përdorimin e platformave elektronike?**

Nëse nxënësit i përdorin platformat elektronike për qëllime mësimi sigurisht se ata përfitojnë njohuri, shkathtësi dhe mund të arrijnë rezultate më të mira të nxënësve, por kjo varet nga angazhimi i tyre dhe i mësuesit.

**13. Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të platformave elektronike?**

Përparësitë e përdorimit të platformave elektronike janë sepse i nxisin dhe i aktivizojnë nxënësit në mësim dhe janë atraktive ndërsa mangësitë e tyre janë se nevojitet patjetër posedimi i internetit dhe disa janë të kufizuara në përdorim.

**14. Sa jeni të kënaqur ju dhe nxënësit me përdorimin e platformave elektronike?**

Mendoj se me përdorimin e platformave elektronike ne dhe nxënësit jemi të kënaqur sepse ato na kanë motivuar për të punuar më shumë ndërsa nxënësit për të mësuar më shumë dhe i ka bërë ata më të përgjegjshëm dhe më të shkathët.

**15. A mund të bëni një krahasim në mes mësimin digjital dhe mësimin tradicional?**

Mësimi tradicional nuk mund të krahasohet me mësimin e realizuar me teknologji sepse përmes pamjeve vizuale nxënësit i kuptojnë më mirë mësimet dhe përfitojnë njohuri, shkathtësi dhe rezultate më të mira.

## INTERVISTA 2

**1. Cila është gjinia juaj?**

Femër.

**2. Cila është fusha e juaj e mësimdhënies?**

Fusha ime e mësimdhënies është Matematika, lënda Matematikë.

**3. A është shkolla juaj e pajisur me kabinet dhe internet?**

Po, shkolla jonë është e pajisur me kabinet dhe internet.

**4. A jeni duke i përdorur platformat elektronike (online) gjatë procesit mësimor?**

Po, sigurisht se jemi duke i përdorur.

**5. Cilat platforma elektronike jeni duke i përdorur gjatë procesit mësimor?**

Jemi duke e përdorur platformën Zoom.

**6. A keni vështirësi gjatë përdorimit të platformave elektronike?**

Mendoj se nuk kemi vështirësi.

**7. Si ndikojnë në procesin mësimor përdorimi i platformave elektronike?**

Sigurisht se përdorimi i platformave elektronike ndikon pozitivisht tek nxënësit gjatë procesit të realizuar mësimor.

**8. A e nxitë interesimin e nxënësve në mësim përdorimi i platformave elektronike?**

Po, e nxitë interesimin e nxënësve në mësim përdorimi i platformave elektronike.

**9. Sa ju ndihmojnë platformat elektronike të bashkëpunoni gjatë procesit mësimor?**

Mendoj se platformat elektronike janë një formë e mirë e bashkëpunimit mes mësimdhënësve dhe nxënësve sepse nxënësit bëhen më të përgjegjshëm në kryerjen e detyrave që ua caktojmë, ku nxënësit duhet patjetër t'i dorëzojnë ato dhe të bashkëpunojnë me ne.

**10. A ofron interaktivitet mes juve dhe nxënësve përdorimi i platformave elektronike?**

Mendoj se ofron interaktivitet përdorimi i platformave elektronike sepse nxënësit qëndrojnë më aktivë gjatë orës mësimore.



**11. Sa i ndihmon nxënësit përdorimi i platformave elektronike për t'i përvetësuar më mirë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre?**

Çdo teknologji elektronike i ndihmon nxënësit gjithashtu dhe platformat elektronike i ka motivuar shumë ata sidomos gjatë realizimit të kuizeve dhe testeve online duke i përvetësuar më mirë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre.

**12. A arrijnë rezultate më të mira nxënësit me përdorimin e platformave elektronike?**

Me përdorimin e platformave elektronike nxënësit mund të arrijnë rezultate më të mira të nxënësve, por duhet pas parasysh që ato t'u përshtaten nxënësve, të mos jenë të komplikuar dhe të jenë të lehta për tu përdorur.

**13. Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të platformave elektronike?**

Përparësitë e përdorimit të platformave elektronike janë aktivizimi dhe përqendrimi më i madh i nxënësve në mësim ndërsa mangësitë e tyre janë se disa janë pak të komplikuar të përdoren dhe shpenzojnë kohë.

**14. Sa jeni të kënaqur ju dhe nxënësit me përdorimin e platformave elektronike?**

Jemi të kënaqur me përdorimin e platformave elektronike sepse nxënësit i ka motivuar shumë sidomos gjatë realizimit të kuizeve dhe testeve online.

**15. A mund të bëni një krahasim në mes mësimin digjital dhe mësimin tradicional?**

Si duket mësimi tradicional nuk po sjell më rezultatet e dëshiruara sepse nxënësit nuk po përqendrohen sa duhet në mësim dhe për këtë arsye përdorimi i teknologjisë në procesin mësimor është i domosdoshëm dhe ka efekt më të madh tek nxënësit.

### INTERVISTA 3

**1. Cila është gjinia juaj?**

Mashkull

**2. Cila është fusha e juaj e mësimdhënies?**

Fusha ime e mësimdhënies është Shkencat e natyrës, lënda Kimi.

**3. A është shkolla juaj e pajisur me kabinet dhe internet?**

Po.

**4. A jeni duke i përdorur platformat elektronike (online) gjatë procesit mësimor?**

Po, jemi duke i përdorur.

**5. Cilat platforma elektronike jeni duke i përdorur gjatë procesit mësimor?**

Jam duke e përdorur platformën Zoom dhe Kahoot.

**6. A keni vështirësi gjatë përdorimit të platformave elektronike?**

Jo, nuk kemi vështirësi pasi tani i kemi perfeksionuar.

**7. Si ndikojnë në procesin mësimor përdorimi i platformave elektronike?**

Mund të them se platformat elektronike mund të ndikojnë pozitivisht dhe i motivojnë nxënësit.

**8. A e nxitë interesimin e nxënësve në mësim përdorimi i platformave elektronike?**

Mendoj se përdorimi i platformave elektronike e nxitë interesimin e nxënësve në mësim, por kjo varet edhe nga angazhimi i nxënësve.

**9. Sa ju ndihmojnë platformat elektronike të bashkëpunoni gjatë procesit mësimor?**

Platformat elektronike janë mënyra më e mirë e bashkëpunimit mes mësimdhënësve dhe nxënësve sepse ato na motivojnë të punojmë më shumë dhe të bëhemi më të përgjegjshëm në punë gjithashtu edhe nxënësit i bënë më të suksesshëm.

**10. A ofron interaktivitet mes juve dhe nxënësve përdorimi i platformave elektronike?**

Përdorimi i platformave elektronike ofron interaktivitet nëse platformat përdoren si duhet sepse ato mund t'i mbajnë nxënësit më të përqendruar në mësim.

**11. Sa i ndihmon nxënësit përdorimi i platformave elektronike për t'i përvetësuar më mirë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre?**

Përdorimi i platformave elektronike i ka ndihmuar nxënësit sepse i ka bërë ata më të aftë, më të shkathët dhe i ka motivuar për të mësuar më shumë.

**12. A arrijnë rezultate më të mira nxënësit me përdorimin e platformave elektronike?**

Nxënësit me përdorimin e platformave elektronike sigurisht se arrijnë rezultate më të mira të të nxënësve gjithashtu i motivon ata që të punojnë më shumë edhe në përmirësimin e rezultateve të tyre.

**13. Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të platformave elektronike?**

Përparësitë e përdorimit të platformave elektronike janë sepse ato i motivojnë nxënësit për të mësuar dhe ofrojnë interaktivitet ndërsa mangësitë e tyre janë se nevojitet patjetër të kemi internet.

**14. Sa jeni të kënaqur ju dhe nxënësit me përdorimin e platformave elektronike?**

Përdorimi i platformave elektronike na ka sjellë kënaqësi gjatë procesit mësimor ndërsa nxënësit i ka bërë më të aftë dhe më të shkathët ndërsa neve na ka lehtësuar edhe punën si mësues.

**15. A mund të bëni një krahasim në mes mësimin digjital dhe mësimin tradicional?**

Mund të them se mësimi digjital i aktivizon dhe i motivon nxënësit sepse ata përqendrohen më shumë në mësim dhe ndërlidhja e teknologjisë me teknikat e mësimin do të ishte një nga format më të mira të mësimdhënies ndërsa mësimi tradicional, nxënësit nuk mund t'i mbajë aktivë në çdo orë mësimore.

## INTERVISTA 4

**1. Cila është gjinia juaj?**

Mashkull.

**2. Cila është fusha e juaj e mësimdhënies?**

Fusha ime e mësimdhënies është Shkencat e natyrës, lënda Biologji.

**3. A është shkolla juaj e pajisur me kabinet dhe internet?**

Po, shkolla jonë është e pajisur.

**4. A jeni duke i përdorur platformat elektronike (online) gjatë procesit mësimor?**

Po, shpeshherë jemi duke i përdorur.

**5. Cilat platforma elektronike jeni duke i përdorur gjatë procesit mësimor?**

Jam duke e përdorur Zoom dhe Google Forms.

**6. A keni vështirësi gjatë përdorimit të platformave elektronike?**

Nganjëherë kemi vështirësi për shkak të mosfunksionimit të internetit.

**7. Si ndikojnë në procesin mësimor përdorimi i platformave elektronike?**

Përdorimi i platformave elektronike në procesin mësimor ndikojnë tek nxënësit në përmirësimin e rezultateve të të nxënësve.

**8. A e nxitë interesimin e nxënësve në mësim përdorimi i platformave elektronike?**

Përdorimi i platformave elektronike e nxitë interesimin e nxënësve në mësim dhe i bënë ata më të përgjegjshëm.

**9. Sa ju ndihmojnë platformat elektronike të bashkëpunoni gjatë procesit mësimor?**

Integrimi i platformave elektronike në mësim është një formë e mirë e bashkëpunimit mes mësimdhënësve dhe nxënësve sepse ato mundësojnë interaktivitet dhe kënaqësi tek nxënësit duke i motivuar ata të punojnë edhe më shumë.

**10. A ofron interaktivitet mes juve dhe nxënësve përdorimi i platformave elektronike?**

Po, ofron interaktivitet mes ne dhe nxënësve përdorimi i platformave elektronike.

**11. Sa i ndihmon nxënësit përdorimi i platformave elektronike për t'i përvetësuar më mirë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre?**

Përdorimi i platformave elektronike i ka ndihmuar shumë nxënësit sepse disa prej tyre kanë përfituar njohuri, shkathtësi dhe rezultate më të mira të të nxënit.

**12. A arrijnë rezultate më të mira nxënësit me përdorimin e platformave elektronike?**

Sa më shumë që përdoren platformat elektronike në procesin mësimor, nxënësit mund të arrijnë rezultate më të mira të të nxënit dhe mund të bëhen më kreativë.

**13. Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të platformave elektronike?**

Përparësitë e përdorimit të platformave elektronike janë sepse nxënësit qëndrojnë më aktivë gjatë orës mësimore dhe bëhen më kreativë ndërsa mangësitë e tyre janë se shumica e platformave disi janë të kufizuara.

**14. Sa jeni të kënaqur ju dhe nxënësit me përdorimin e platformave elektronike?**

Mendoj se ne dhe nxënësit jemi mjaftë të kënaqur me përdorimin e platformave elektronike sepse disa prej nxënësve kanë përfituar njohuri, shkathtësi dhe rezultate më të mira të të nxënit.

**15. A mund të bëni një krahasim në mes mësimin digjital dhe mësimin tradicional?**

Mësimi tradicional shkakton monotoni andaj nuk mund të krahasohet me mësimin digjital sepse është nevojë e kohës dhe domosdoshmëri që ato të përdoren në procesin mësimor dhe të integrohen në çdo orë mësimore përveç në raste të rralla kur teknologjia nuk mund të integrohet në mësim për shkak të njësisë së papërshtatshme mësimore.

## INTERVISTA 5

### 1. Cila është gjinia juaj?

Femër.

### 2. Cila është fusha e juaj e mësimdhënies?

Fusha ime e mësimdhënies është Gjuhët dhe Komunikimi, lënda Gjuhë Shqipe.

### 3. A është shkolla juaj e pajisur me kabinet dhe internet?

Po.

### 4. A jeni duke i përdorur platformat elektronike (online) gjatë procesit mësimor?

Po, jemi duke i përdorur.

### 5. Cilat platforma elektronike jeni duke i përdorur gjatë procesit mësimor?

Jam duke e përdorur platformën Zoom dhe Edmodo.

### 6. A keni vështirësi gjatë përdorimit të platformave elektronike?

Po, ndodhë nganjëherë të kemi vështirësi.

### 7. Si ndikojnë në procesin mësimor përdorimi i platformave elektronike?

Mendoj se me përdorimin e platformave elektronike nxënësit përfitojnë njohuri, shkathtësi dhe rezultate më të mira të të nxënësve gjithashtu platformat elektronike mund të ndikojnë në ngritjen e cilësisë në arsim.

### 8. A e nxitë interesimin e nxënësve në mësim përdorimi i platformave elektronike?

Përdorimi i platformave elektronike mund të nxisë interesimin e nxënësve në mësim, por jo çdo herë, kjo varet edhe nga njësia mësimore se sa është e përshtatshme për nxënës.

### 9. Sa ju ndihmojnë platformat elektronike të bashkëpunoni gjatë procesit mësimor?

Sigurisht se përdorimi i platformave elektronike në procesin mësimor mundëson bashkëpunim mes ne dhe nxënësve, i nxitë nxënësit më shumë duke i bërë ata më të shkathët dhe më punëtorë.

### 10. A ofron interaktivitet mes juve dhe nxënësve përdorimi i platformave elektronike?

Platformat elektronike ofrojnë interaktivitet nëse përdoren në mënyrën e duhur sepse ato na motivojnë ne dhe nxënësit.

**11. Sa i ndihmon nxënësit përdorimi i platformave elektronike për t'i përvetësuar më mirë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre?**

Sigurisht se përdorimi i platformave elektronike i ka ndihmuar nxënësit sidomos me realizimin e kuizeve përmes platformës Kahoot, gjë që ka ndikuar tek nxënësit që t'i përvetësojnë më mirë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre.

**12. A arrijnë rezultate më të mira nxënësit me përdorimin e platformave elektronike?**

Me përdorimin e platformave elektronike nxënësit arrijnë rezultate më të mira të të nxënësve, por duhet zgjedhur se cilat platforma duhet përdorur në mënyrë që ata të kenë sukses në arritjen e rezultateve të dëshiruara.

**13. Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të platformave elektronike?**

Përparësitë e përdorimit të platformave elektronike janë motivimi dhe angazhimi më i madh nxënësve në mësim dhe përfundimi i njohurive, shkathtësive dhe rezultateteve më të mira të të nxënësve ndërsa mangësitë e tyre janë se platformat janë të kufizuara dhe duhet patjetër të posedohet interneti.

**14. Sa jeni të kënaqur ju dhe nxënësit me përdorimin e platformave elektronike?**

Sigurisht se me përdorimin e platformave elektronike jemi të kënaqur sepse ato kanë ndikuar tek nxënësit që t'i përvetësojnë më mirë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre.

**15. A mund të bëni një krahasim në mes mësimi digjital dhe mësimi tradicional?**

Mësimi i realizuar përmes teknologjisë është më nxitës dhe më atraktiv për nxënësit sepse ata i mbanë më aktivë dhe më të përqendruar ndërsa mësimi tradicional nuk i aktivizon çdo herë nxënësit dhe shpesh ata humbin interesimin për të mësuar. Për këtë arsye mësimi i realizuar me teknologji është në avantazh ndaj mësimi tradicional.

**4.3. Analiza e të dhënave cilësore**

Të dhënat cilësore mundësojnë grumbullimin e të dhënave përmes anketimeve, në këtë rast përmes intervistave të realizuara me mësimdhënësit e shkollës, të cilat na ndihmojnë të arrijmë në konkluzione të sakta. Analizën e intervistave të realizuara me mësimdhënësit, e kemi paraqitur në vijim.

Në pyetjen: *1. Cila është gjinia e juaj?*, mësimdhënësit janë deklaruar se dy prej tyre i takojnë gjinisë femërore dhe tre gjinisë mashkullore.

Në pyetjen: 2. *Cila është fusha e juaj e mësimdhënies?*, mësimdhënësit janë deklaruar se i takojnë fushave të ndryshme, një i takon fushës Jeta dhe Puna apo lëndës TIK, një fushës Matematika apo lëndës së Matematikës, dy fushës Shkencat e Natyrës apo lëndëve Biologji dhe Kimi dhe një fushës Gjuhët dhe Komunikimi apo lëndës së gjuhës Shqipe.

Në pyetjen: 3. *A është shkolla juaj e pajisur me kabinet dhe internet?*, mësimdhënësit janë deklaruar se shkolla e tyre është e pajisur me kabinet dhe internet.

Në pyetjen: 4. *A jeni duke i përdorur platformat elektronike (online) në procesin mësimor?*, mësimdhënësit janë deklaruar se janë duke i përdorur disa prej platformave elektronike apo online.

Në pyetjen: 5. *Cilat platforma elektronike jeni duke i përdorur gjatë procesin mësimor?*, mësimdhënësit janë deklaruar se janë duke i aplikuar disa prej platformave elektronike, si Zoom, Edmodo, Kahoot dhe Google Forms.

Në pyetjen: 6. *A keni vështirësi gjatë përdorimit të platformave elektronike?*, mësimdhënësit janë deklaruar se disa prej tyre nganjëherë kanë vështirësi gjatë përdorimit për shkak të mosfunksionimit të internetit.

Në pyetjen: 7. *Si ndikojnë në procesin mësimor përdorimi i platformave elektronike?*, mësimdhënësit janë deklaruar se, të gjitha platformat elektronike ndikojnë pozitivisht në procesin mësimor dhe i motivojnë nxënësit gjithashtu ata përfitojnë njohuri, shkathtësi dhe rezultate më të mira të të nxënit po ashtu ato mund të ndikojnë edhe në ngritjen e cilësisë në arsim.

Në pyetjen: 8. *A e nxitë interesimin e nxënësve në mësim përdorimi i platformave elektronike?*, mësimdhënësit janë deklaruar se, përdorimi i platformave elektronike e nxitë interesimin e nxënësve për të mësuar më shumë, i bënë ata më të përgjegjshëm, por kjo varet edhe nga angazhimi i nxënësve dhe nga njësia mësimore se sa është e përshtatshme për nxënësit.

Në pyetjen: 9. *Sa ju ndihmojnë platformat elektronike të bashkëpunoni gjatë procesit mësimor?*, mësimdhënësit janë deklaruar se, gjatë përdorimit të platformave, si Zoom, Edmodo dhe Kahoot, nxënësit kanë qenë më të angazhuar dhe bashkëpunimi ka qenë në nivelin e duhur, kjo për shkak të përdorimit dhe integritit të teknologjisë në procesin mësimor, gjithashtu i ka motivuar nxënësit të punojmë më shumë, duke u bërë më të përgjegjshëm në punë dhe më të suksesshëm.



Në pyetjen: *10. A ofron interaktivitet mes juve dhe nxënësve përdorimi i platformave elektronike?*, mësimdhënësit janë deklaruar se, përdorimi i platformave elektronike ofron interaktivitet mes ne dhe nxënësve nëse ato përdoren në mënyrën e duhur sepse i motivon nxënësit për të punuar më shumë sepse ata qëndrojnë më aktivë dhe janë më të përqendruar gjatë orës mësimore.

Në pyetjen: *11. Sa i ndihmon nxënësit përdorimi i platformave elektronike për t'i përvetësuar më mirë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre?*, mësimdhënësit janë deklaruar se, përdorimi i platformave elektronike i ka ndihmuar shumë nxënësit, i ka bërë ata më të shkathët, më të përgjegjshëm, më të aftë dhe i ka ndihmuar për të arritur rezultate më të mira në mësim, kështu duke i përvetësuar më mirë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre.

Në pyetjen: *12. A arrijnë rezultate më të mira nxënësit me përdorimin e platformave elektronike?*, mësimdhënësit janë deklaruar se, nëse nxënësit i përdorin platformat elektronike për qëllime mësimi sigurisht se ata përftojnë njohuri, shkathtësi dhe arrijnë rezultate më të mira të të nxënësve, të bëhen më kreativë, por duhet zgjedhur se cilat platforma duhet përdorur, në mënyrë që t'u përshtaten nxënësve dhe ata të kenë sukses në arritjen e rezultateve të dëshiruara, por kjo varet nga angazhimi i tyre dhe i mësimdhënësit.

Në pyetjen: *13. Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të platformave elektronike?*, mësimdhënësit janë deklaruar se, përparësitë përdorimit të platformave elektronike janë sepse i nxisin dhe i aktivizojnë nxënësit në mësim, ofrojnë interaktivitet dhe janë atraktive për nxënësit gjithashtu disa prej nxënësve me përdorimin e platformave elektronike kanë përfitur njohuri, shkathtësi dhe rezultate më të mira të të nxënësve ndërsa mangësitë e platformave elektronike janë se nevojitet patjetër posedimi i internetit, disa janë të kufizuara dhe të komplikuar të përdoren dhe disa shpenzojnë kohë.

Në pyetjen: *14. Sa jeni të kënaqur ju dhe nxënësit me përdorimin e platformave elektronike?*, mësimdhënësit janë deklaruar se, me përdorimin e platformave elektronike ne dhe nxënësit jemi të kënaqur sepse ato na kanë motivuar për të punuar më shumë ndërsa nxënësit për të mësuar më shumë sidomos gjatë realizimit të kuizeve dhe testeve online dhe i ka bërë ata më të përgjegjshëm dhe më të shkathët sepse disa prej nxënësve kanë përfitur njohuri, shkathtësi dhe rezultate më të mira të të nxënësve ndërsa neve si mësimdhënës na ka lehtësuar punën shumë.

Në pyetjen: *15. A mund të bëni një krahasim në mes mësimin digjital dhe mësimin tradicional?*, mësimdhënësit janë deklaruar se, mësimi tradicional nuk mund të krahasohet me mësimin e

realizuar me teknologji sepse nxënësit përmes teknologjisë apo pamjeve vizuale i kuptojnë më mirë mësimet dhe ka efekt më të madh tek nxënësit sepse përqendrohen më shumë në mësim dhe teknologjia është nevojë e kohës dhe e domosdoshme që të përdoret dhe të integrohet në procesin mësimor, në mënyrë që nxënësit të aktivizohen dhe motivohen dhe për të mos e humbur interesimin për të mësuar. Për këtë arsye mësimi digjital është në avantazh ndaj mësimin tradicional.

#### 4.4. Testimi i hipotezave

Testimin e hipotezave e kemi bërë përmes programit SPSS me testin Hi-Katror, ku i kemi paraqitur rezultatet rreth hipotezave të ngritura në hulumtim, të cilat i kemi interpretuar dhe paraqitur, si më poshtë.

Rezultatet e hipotezës H1 përmes testit Hi-Katror (Chi-Square), i kemi paraqitur si në vijim:

Tabela 32. Statistika përshkruese

	N	Mean (Mesatarja)	Std.Deviation (Dev.Standard)	Min (Minimum)	Max (Maksimum)	Percentiles (Përqindjet)		
						25th	50th	75th
H	125	2.30	1.057	1	4	1.00	2.00	3.00

Tabela 33. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve

	Observed N (Vlera e Vëzhguar)	Expected N (Vlera e Pritur)	Residual (Mbetja)
Shumë	39	31.3	7.8
Mjaft	26	31.3	-5.3
Disi	43	31.3	11.8
Aspak	17	31.3	-14.3
Total	125		

Tabela 34. Testi statistikor

Chi-Square (Hi-Katror)	df (Shkallet e lirisë)	Asymp. Sig. (Signifikanta Asimptotike)
13.720 <sup>a</sup>	3	.003

Në pjesën e parë të rezultateve janë të paraqitura rezultatet e nxjerra nga programi SPSS përmes butonit Options. Sipas kësaj, numri total i nxënësve është N=125 dhe mesatarja (mean) 2.30. Në mes janë paraqitur opsionet, alternativa e parë apo numri më i vogël (Minimumi) është 1 dhe alternativa e fundit apo numri më i lartë (Maksimumi) është 4.

Sipas analizës, janë nxjerrë vlerat e vrojtuar dhe të pritura të nxënësve (Observed N dhe Expected N si dhe Residual), e cila tregon dallimin pozitiv apo negativ të vlerave të vrojtuar dhe të pritura. Në total janë 125 nxënës dhe sipas tyre, vlera e pritur është llogaritur si 31.3. Qëllimi në testin e Hi-Katrorit është përcaktimi i dallimit ndërmjet vlerave të vrojtuar të nxënësve me vlerën e pritur (31.3). Pra, do të testohet përshtatshmëria ndërmjet vlerës së vrojtuar dhe vlerës së pritur.

Në shembullin tonë, për arsye se vlera e Signifikantes Asimptotike është 0.003 dhe është më e vogël se niveli i rëndësisë që është Sig ( $P < 0.05$ ), atëherë pranohet hipoteza H1:

*H1. Përdorimi i platformave elektronike e nxitë interesimin e nxënësve në mësim.*

Prandaj, ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet vlerave të anketuarve. Kurse vlera e Hi-Katrorit (Chi-Square) është përcaktuar si 13.720.

Rezultatet e hipotezës H2 përmes testit Hi-Katror (Chi-Square), i kemi paraqitur si në vijim:

**Tabela 35. Statistika përshkruese**

	N	Mean (Mesatarja)	Std.Deviation (Dev.Standard)	Min (Minimum)	Max (Maksimum)	Percentiles (Përqindjet)		
						25th	50th	75th
<b>H</b>	125	2.35	1.123	1	4	1.00	2.00	3.00

**Tabela 36. Vlerat e vëzhguara dhe të pritura të nxënësve**

	Observed N (Vlera e Vëzhguar)	Expected N (Vlera e Pritur)	Residual (Mbetja)
Po	35	31.3	3.8
Ndoshta	40	31.3	8.8
Jo	21	31.3	-10.3
Nuk e di	29	31.3	-2.3
Total	125		

**Tabela 37. Testi statistikor**

Chi-Square (Hi-Katror)	df (Shkallet e lirisë)	Asymp. Sig. (Signifikanta Asimptotike)
6.424 <sup>a</sup>	3	.093

Në pjesën e parë të rezultateve janë të paraqitura rezultatet e nxjerra nga programi SPSS përmes butonit Options. Sipas kësaj, numri total i nxënësve është  $N=125$  dhe mesatarja (mean) 2.35. Në mes janë paraqitur opsionet, alternativa e parë apo numri më i vogël (Minimumi) është 1 dhe alternativa e fundit apo numri më i lartë (Maksimumi) është 4.

Sipas analizës, janë nxjerrë vlerat e vrojtuar dhe të pritura të nxënësve (Observed N dhe Expected N si dhe Residual), e cila tregon dallimin pozitiv apo negativ të vlerave të vrojtuar dhe të pritura. Në total janë 125 nxënës dhe sipas tyre, vlera e pritur është llogaritur si 31.3. Qëllimi në testin e Hi-Katrorit është përcaktimi i dallimit ndërmjet vlerave të vrojtuar të nxënësve me vlerën e pritur (31.3). Pra, do të testohet përshtatshmëria ndërmjet vlerës së vrojtuar dhe vlerës së pritur.

Në shembullin tonë, për arsye se vlera e Signifikantes Asimptotike është 0.093 dhe është më e madhe se niveli i rëndësisë që është Sig ( $P < 0.05$ ), atëherë refuzohet hipoteza H2:

*H2. Nxënësit me përdorimin e platformave elektronike arrijnë rezultate më të mira në mësim.*

Prandaj, nuk ekziston ndonjë dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet vlerave të anketuarve. Kurse vlera e Hi-Katrorit (Chi-Square) është përcaktuar si 6.424.

## 5. DISKUTIMI DHE KONKLUDIMET

Qëllimi i këtij studimi ishte perceptimi i mësimeve dhe nxënësve gjatë përdorimit të platformave elektronike (online) në edukim, pastaj përparësitë, mangësitë dhe ndikimi i tyre tek nxënësit e nivelit të mesëm të lartë shkollor në komunën e Drenasit, gjatë periudhës së pandemisë të quajtur COVID-19.

Sipas këtij hulumtimi dhe sipas studimeve të bëra nga autorë të ndryshëm, përdorimi i platformave elektronike (online) ka ndikuar pozitivisht tek nxënësit duke i aktivizuar dhe motivuar nxënësit dhe duke i bërë ata më të përgjegjshëm, më kreativë, bashkëpunues dhe njëkohësisht edhe më të përqendruar në mësim. Pra, duke i përdorur teknologjitë e ndryshme në procesin mësimor, nxënësit përjetojnë ndryshime në aspektin e të mësuarit dhe largohen nga mësimi tradicional, i cili shpeshherë u shkakton monotoni. Në këtë mënyrë mësimi i realizuar me teknologji duke i përshtatur ato për nxënësit dhe duke i bërë ato sa më atraktive, i nxitë nxënësit dhe ju ofron kënaqësi gjatë orës mësimore, i bënë ata më të suksesshëm dhe ndikon në rritjen e rezultateve të tyre.

Pyetjet hulumtuese për të cilat kemi marrë përgjigje janë:

### **1. Cilat platforma elektronike janë duke u përdorur gjatë procesit mësimor?**

Përgjigjet për këtë pyetje gjenden tek intervista me mësimeve (faqe 46, tek pyetja nr. 5) dhe tek pyetësi me nxënës (faqe 25, tek pyetja nr. 5), të cilat i kemi paraqitur si në vijim:

*Mësimeve janë deklaruar se janë duke i aplikuar disa prej platformave elektronike, si Zoom, Edmodo, Kahoot dhe Google Forms.*

*Ndërsa nxënësit janë deklaruar se, 107 apo 85% prej tyre e kanë përdorur platformën Zoom, 73 apo 58% platformën Kahoot, 52 apo 41% platformën Edmodo dhe 46 apo 36% platformën Google Forms.*

Nga ky anketim shihet se, mësimeve dhe nxënësit gjatë procesit mësimor më shumë i kanë përdorur platformat elektronike Zoom, Kahoot, Edmodo dhe Google Forms.

### **2. A kanë vështirësi mësimeve dhe nxënësit gjatë përdorimit të platformave elektronike?**

Përgjigjet për këtë pyetje gjenden tek intervista me mësimeve (faqe 46, tek pyetja nr. 6) dhe tek pyetësi me nxënës (faqe 26, tek pyetja nr. 6), të cilat i kemi paraqitur si në vijim:

*Mësimeve janë deklaruar se disa prej tyre nganjëherë kanë vështirësi gjatë përdorimit për shkak të mosfunksionimit të internetit.*

*Ndërsa nxënësit janë deklaruar se, 64 apo 51% prej tyre rrallëherë kanë vështirësi gjatë përdorimit të platformave elektronike, 49 apo 39% nganjëherë kanë vështirësi dhe 12 apo 10% shpeshherë kanë vështirësi.*

Nga ky anketim shihet se, mësimdhënësit dhe nxënësit gjatë përdorimit të platformave elektronike kanë pasur pak vështirësi.

### **3. A e nxitë interesimin e nxënësve në mësim përdorimi i platformave elektronike?**

Përgjigjet për këtë pyetje gjenden tek intervista me mësimdhënësit (faqe 46, tek pyetja nr.8) dhe tek pyetësi me nxënës (faqe 28, tek pyetja nr. 8), të cilat i kemi paraqitur si në vijim:

*Mësimdhënësit janë deklaruar se, përdorimi i platformave elektronike e nxitë interesimin e nxënësve për të mësuar më shumë, i bënë ata më të përgjegjshëm, por kjo varet edhe nga angazhimi i nxënësve dhe nga njësia mësimore se sa është e përshtatshme për nxënës.*

*Ndërsa nxënësit janë deklaruar se, 39 apo 31% prej tyre përdorimi i platformave elektronike e nxitë shumë interesimin e nxënësve në mësim, 26 apo 21% i nxitë mjaft, 43 apo 34% i nxitë disi dhe 17 apo 14% nuk i nxitë aspak.*

Nga ky anketim shihet se, përdorimi i platformave elektronike e nxitë interesimin e nxënësve në mësim.

### **4. A arrijnë rezultate më të mira nxënësit me përdorimin e platformave elektronike?**

Përgjigjet për këtë pyetje gjenden tek intervista me mësimdhënësit (faqe 47, tek pyetja nr. 12) dhe tek pyetësi me nxënës (faqe 32, tek pyetja nr. 12), të cilat i kemi paraqitur si në vijim:

*Mësimdhënësit janë deklaruar se, nëse nxënësit i përdorin platformat elektronike për qëllime mësimi sigurisht se ata përftojnë njohuri, shkathhtësi dhe mund të arrijnë rezultate më të mira të të nxënësve, mund të bëhen më kreativë, por duhet zgjedhur se cilat platforma duhet përdorur, në mënyrë që t'u përshtaten nxënësve dhe ata të kenë sukses në arritjen e rezultateve të dëshiruara, por kjo varet nga angazhimi i tyre dhe i mësimdhënësit.*

*Ndërsa nxënësit janë deklaruar se, 35 apo 28% prej tyre me përdorimin e platformave elektronike kanë arritur rezultate më të mira në mësim, 40 apo 32% kanë thënë ndoshta arrijnë, 21 apo 17% kanë thënë se nuk arrijnë dhe 29 apo 23% kanë thënë se nuk e dinë.*

Nga ky anketim shihet se, mësimdhënësit dhe nxënësit me përdorimin e platformave elektronike kanë mendime të ndryshme për arritjen e rezultateve më të mira në mësim.

Hipotezat e hulumtimit për të cilat kemi marrë përgjigje janë:

*H1. Përdorimi i platformave elektronike e nxitë interesimin e nxënësve në mësim.*

Vërtetimi i hipotezës së parë H1 gjendet tek pyetësi me nxënës (faqe 28, tek pyetja nr. 8 dhe faqe 48, tek tabela nr. 5), e vërtetuar në programin SPSS me testin Hi-Katror (Chi-Square), të cilën e kemi paraqitur si në vijim:

*“Rezultati i Signifikantes Asimptotike Sig ( $p = 0,003$ ) tregon se hipoteza H1 është vërtetuar pra, pranohet sepse vlera e saj është më e vogël se 0.05 dhe është brenda intervalit të besueshmërisë prej 95%. Pra, nxënësit janë deklaruar se, 39 apo 31% prej tyre përdorimi i platformave elektronike e nxitë shumë interesimin e nxënësve në mësim, 26 apo 21% i nxitë mjaft, 43 apo 34% i nxitë disi dhe 17 apo 14% nuk i nxitë aspak.”*

Nga rezultatet e nxënësve dhe me testimin e hipotezës në programin SPSS mund të themi se hipoteza e parë e ngritur H1 pranohet sepse është brenda nivelit të rëndësisë Sig ( $P < 0.05$ ).

*H2. Nxënësit me përdorimin e platformave elektronike arrijnë rezultate më të mira në mësim.*

Vërtetimi i hipotezës së dytë H2 gjendet tek pyetësi me nxënës (faqe 32, tek pyetja nr. 12 dhe faqe 49, tek tabela nr. 8), e vërtetuar në programin SPSS me testin Hi-Katror (Chi-Square), të cilën e kemi paraqitur si në vijim:

*“Rezultati i Signifikantes Asimptotike Sig ( $p = 0,093$ ) tregon se hipoteza H2 nuk është vërtetuar pra, refuzohet sepse vlera e saj është më e madhe se 0.05 dhe është jashtë intervalit të besueshmërisë prej 95%. Pra, nxënësit janë deklaruar se, 35 apo 28% prej tyre me përdorimin e platformave elektronike arrijnë rezultate më të mira në mësim, 40 apo 32% kanë thënë ndoshta arrijnë, 21 apo 17% kanë thënë se nuk arrijnë dhe 29 apo 23% kanë thënë se nuk e dinë.*

Nga rezultatet e nxënësve dhe me testimin e hipotezës në programin SPSS mund të themi se hipoteza e dytë e ngritur H2 refuzohet sepse është jashtë nivelit të rëndësisë Sig ( $P < 0.05$ ).

Në përfundim mund të themi se përdorimi i platformave elektronike (online) në edukim ka pasur një ndikim të jashtëzakonshëm tek nxënësit pasi një shumicë dërrmuese e tyre e perceptuan përdorimin e platformave elektronike si një teknologji inovative e të mësuarit dhe përmirësim të njohurive të përgjithshme të tyre kompjuterike. Mund të themi se nxënësit e pranojnë teknologjinë si pjesë të procesit mësimor dhe e përjetojnë përdorimin e platformave elektronike si arritje e rëndësishme e kompetencës.

Një studim në Hong Kong (Tavares dhe Chu, 2012) tregon se, nxënësit që përdorën platformat elektronike në lëndën e Gjuhës Angleze, në përgjithësi u ndanë të kënaqur me këtë platformë, u motivuan dhe përfituan njohuri me rastin e praktikimit dhe shkrimit të Gjuhës Angleze dhe mësuuan nga njëri-tjetri.

Një studim tjetër në Tajlandë (Henry, 2011), nxënësit që kishin përdorur platformat elektronike në lëndën e Matematikës, mësimdhënësi i tyre kishte vendosur video ku një mësimdhënësi shpjegonte koncepte të vështira matematikore, kështu që nxënësit i përdornin këto video për të rifreskuar mësimet gjithashtu në platformë mësimdhënësi kishte vendosur edhe lojëra interaktive dhe kuize përmes platformave elektronike dhe nxënësit kishin arritur rezultate më të mira të të nxënësve.

Gjithashtu një studim i realizuar në Tajvan (Yuang-Ling Lai, 2013), tregon se teknologjitë Web 2.0 përkatësisht platformat elektronike, i nxitë nxënësit për të bashkëpunuar dhe në gjenerimin e ideve të reja, promovimin e komunikimit, ndarjen e informacionit, duke u mundësuar nxënësve që të përfshihen më shumë në projekte grupore në mënyrë efektive duke përfshirë mbështetjen për të shkruar projekte individuale dhe në grupe, etj.

Studimet e huaja tregojnë qartë se me përdorimin e platformave elektronike nxënësit kanë qenë më të motivuar, më bashkëpunues, janë përfshirë në projekte individuale dhe grupore, kanë ndarë informacionet, kanë gjeneruar ide të reja dhe në këtë mënyrë kanë përfituar njohuri dhe rezultate më të mira të të nxënësve.

Andaj, rezultatet e nxjerra nga ky hulumtim tregojnë se përdorimi i platformave elektronike (online) në edukim ka ndikuar pozitivisht tek nxënësit sepse ata gjatë procesit mësimor kanë qenë më aktivë, më kreativë, më bashkëpunues, kanë mësuar gjëra të reja dhe janë përkushtuar më shumë në mësim dhe në kryerjen e detyrave dhe projekteve të tyre, i ka bërë ata më të përgjegjshëm dhe më të motivuar duke i përvetësuar më mirë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre dhe duke arritur rezultate më të mira të të nxënësve, etj.

Gjithashtu përdorimi i platformave elektronike ka mundësuar interaktivitetet në mes mësimdhënësve dhe nxënësve duke rritë efikasitetin e mësimdhënies dhe nxënies sepse mësimdhënësit i ka nxitë dhe i ka ngritë në profesion ndërsa nxënësit i ka bërë më të përgjegjshëm, më të shkathët, më produktivë, më të suksesshëm dhe ka ndikuar në përmirësimin e rezultateve të të nxënësve.



## 6. REKOMANDIMET

Sipas hulumtimit të bërë, rekomandohet që gjatë procesit mësimor të përdoren platformat elektronike (online) sepse nxënësve u ndihmon në arritjen e rezultateve më të mira të të nxënit ndërsa mësimdhënësit të arrijnë qëllimin e tyre të mësimdhënies dhe plotësimin e kërkesave të kurrikulës.

### **Rekomandime për mësimdhënësit**

Rekomandohet që mësimdhënësit të zbatojnë strategji të ndryshme të mësimdhënies, duke aplikuar teknologjinë elektronike në procesin mësimor apo duke përdorur metoda dhe teknika të ndryshme që nxitë nxënësit për të mësuar.

Mësimdhënësit gjatë përdorimit të teknologjive duhet t'i kushtojnë rëndësi atyre dhe t'i përshtatin ato për nxënësit duke i shfrytëzuar ato në formë mësimi dhe argëtimi.

Mësimdhënësit të vlerësojnë efektivitetin e teknologjive elektronike në mësimdhënie dhe nxënie dhe në bazë të kësaj ata mund të rrisin produktivitetin e nxënësve dhe praktikën e tyre profesionale. Andaj, të gjithë mësimdhënësit duhet integruar teknologjinë elektronike në institucionet shkollore përmes të nxënit bashkëpunues, duke zhvilluar veprimtari që zhvillohen në klasë dhe nga distanca.

### **Rekomandime për nxënësit**

Nxënësit të vetëdijesohen për të përdorur teknologjitë elektronike në mësim nga një këndvështrim funksional, nëse shprehinë bazë, si të lexuarit, të shkruarit, të vizatuarit dhe shprehi të tjera janë zotëruar.

Nxënësit të kërkojnë edukim për teknologji të informacionit dhe komunikimit dhe të kërkojnë informacione, për të gjetur sa më shumë shembuj nga njësia përkatëse, por edhe jashtë temës mësimore, që ka të bëjë me aspektin edukativ.

Nxënësit duhet të rrisin komunikimin e tyre me mësimdhënësit përmes platformave elektronike dhe duhet të jenë pjesëmarrës në projekte shkollore dhe të kenë mundësi të përdorin shprehinë kompjuterike.

### **Rekomandime për prindërit**

Prindërit duhet t'ia plotësojnë kushtet fëmijëve të tyre sipas mundësive që i kanë, rreth pajisjes së tyre me teknologji elektronike në shtëpitë e tyre dhe t'i përdorin ato në mënyrën e duhur.

Të bashkëpunojnë me shkollat duke u interesuar për edukimin e mirëfilltë të fëmijëve në shkollë gjithashtu prindërit së bashku me mësimdhënësit të komunikojnë dhe të kujdesen për suksesin e fëmijëve dhe sjelljet e tyre në shkollë.

## REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE

- Ali, F. (2018). *Use of Google Forms in teaching and assessing english phonology*. Basra: JBRHS.
- Aljraiwi, S. (2017). *The effect of classroom web applications on teaching and learning*. Arabi Saudite: CCSE.
- Alqahtani, A. (2019). *The use of edmodo: its impact on learning and students' attitudes toward it*. Saudi Arabia: JITER.
- Arbnor Pajaziti, A. D. (2016). *Teknologjia me TIK 9*. Pejë: Dukagjini.
- Bashkim Azemi, R. B. (2013). *Bazat e kërkimit në edukim*. Prishtinë: IPK.
- Boachie, E. (2016). *The effectiveness of Microsoft Excel to improve students continuous assessment in secondary schools*. Ghana: IJTRD.
- Bob Matthews, L. R. (2010). *Metodat e Hulumtimit - Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane*. Tiranë: CDE.
- Cisco. (2010). *PC Hardware and Software v4.1*. USA: Cisco.
- Cummins, J. (2007). *Literacy, Technology, and Diversity: Teaching for Success in Changing Times*. Boston: ABP.
- Darren Iwamoto, J. H. (2017). *Analyzing the efficacy of the testing effect using kahoot on student performance*. USA: TOJDE.
- ECDL. (2010). *European Computer Driving Licence*. Prishtinë: Smart Bits.
- Fateme S. Lari. (2014). *The impact of using PowerPoint presentations on students' learning and motivation in secondary schools*. Iran: ELSEVIER.
- Fullan, M. (2002). *Forcat e ndryshimit: depërtim në thellësitë e reformës arsimore*. Tiranë: CDE.
- Fung, A. (2012). *Management of Education in the Information Age: The Role of ICT*. USA: Springer.

- Guzacheva, N. (2020). *Zoom technology as an effective tool for distance learning*. Uzbekistan: BSP.
- Hameli, K. (2017). *Tenikat statistikore me shumë ndryshore me aplikim në SPSS*. Stamboll.
- Hanum, N. (2016). *The importance of classroom interaction in the teaching of reading in junior high school*. Indonezi: ELT.
- Henry, Y. (2011). *Using Google Sites to communicate with parents*. Tajlandë: DSIL.
- Hung, M. (2017). *A Study of the Effects of Digital Learning on Learning Motivation and Learning Outcome*. China.
- Jethro, O. (2012). *E-Learning and its effects on teaching and learning in a global age*. Nigeri: IJARBSS.
- Karlin & Ozogul . (2016). *The Practical Application of e-Portfolios in K-12 Classrooms*. TechTrends.
- Katie, R. (2017). *The Schoology and Google Drive Integration*. Kentaki: TalkTech.
- Leon Shklar, R. R. (2013). *Web application architecture*. Angli: WILEY.
- Licorish, S. (2018). *Students' perception of Kahoot!'s influence on teaching and learning*. New Zealand: RPTEL.
- MASHT. (2011). *Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016*. Prishtinë.
- MASHT. (2020). *Udhëzues për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë*. Prishtinë.
- Mexhuani, A. (2014). *Integrimi i teknologjisë informative të komunikimit në mësimdhënie dhe nxënie*. Prishtinë: IPK.
- Nicole Tavares, S. C. (2012). *Experimenting with english collaborative writing on Google Sites*. Hong Kong: CITE.
- Poungtong Udomsil, S. P. (2016). *A development of causal relationship model of the Google Sites usage for learning at Rangsit University*. Tajlandë: KMICE.
- Wauters, R. (2010). *Schoology - Learning Management Software*. Indonezi: TECH.

## SHTOJCA A: PYETËSORI PËR NXËNËS

**1. Cila është gjinia juaj?**

- Femër
- Mashkull

**2. Cila është mosha juaj?**

- 15 vjeç
- 16 vjeç
- 17 vjeç

**3. A është shkolla juaj e pajisur me kabinet dhe internet?**

- Po
- Jo

**4. A jeni duke i përdorur platformat elektronike-online gjatë procesit mësimor?**

- Po, rregullisht
- Shpeshherë
- Nganjëherë
- Jo, Asnjëherë

**5. Cilat platforma elektronike jeni duke i përdorur gjatë procesit mësimor?**

- Zoom
- Edmodo
- Schoology
- Kahoot
- Google Forms
- Polleverywhere
- Tjetër\_\_\_\_\_

**6. A keni vështirësi gjatë përdorimit të platformave elektronike?**

- Shpeshherë
- Nganjëherë
- Rrallëherë
- Asnjëherë

**7. Si ndikon në procesin mësimor përdorimi i platformave elektronike?**

- Pozitivisht
- Negativisht
- Nuk ndikon fare

**8. A e nxitë interesimin në mësim përdorimi i platformave elektronike?**

- Po, e nxitë shumë
- E nxitë mjaft
- E nxitë disi
- Nuk e nxitë aspak

**9. Sa ju ndihmojnë platformat elektronike të bashkëpunoni gjatë procesit mësimor?**

- Shumë
- Mjaft
- Disi
- Aspak

**10. A ofron interaktivitet mes juve dhe mësimdhënësve përdorimi i platformave elektronike?**

- Po, ofron shumë
- Ofron mjaft
- Ofron disi
- Nuk ofron aspak

**11. Sa ju ndihmon përdorimi i platformave elektronike për t'i përvetësuar më mirë njohuritë dhe shkathtësitë e juaja?**

- Shumë
- Mjaft
- Disi
- Aspak

**12. A arrini rezultate më të mira në mësim me përdorimin e platformave elektronike?**

- Po
- Jo
- Ndoshta
- Nuk e di

**13. Cilat janë përparësitë e përdorimit të platformave elektronike?**

- Qasja e lehtë
- Ofronjë bashkëpunim
- Mundësojnë reagime
- Janë atraktive
- Janë motivuese

**14. Cilat janë mangësitë e përdorimit të platformave elektronike?**

- Nevojitet interneti
- Duhet regjistruar
- Janë të kufizuara
- Nuk janë të sigurta
- Janë të komplikuar

**15. Sa jeni të kënaqur me përdorimin e platformave elektronike?**

- Shumë
- Mjaft
- Disi
- Aspak

## SHTOJCA B: INTERVISTA PËR MËSIMDHËNËS

1. Cila është gjinia juaj?

---

2. Cila është fusha e juaj e mësimdhënies?

---

3. A është shkolla juaj e pajisur me kabinet dhe internet?

---

4. A jeni duke i përdorur platformat elektronike (online) gjatë procesit mësimor?

---

5. Cilat platforma elektronike jeni duke i përdorur gjatë procesit mësimor?

---

6. A keni vështirësi gjatë përdorimit të platformave elektronike?

---

7. Si ndikon në procesin mësimor përdorimi i platformave elektronike?

---

8. A e nxitë interesimin e nxënësve në mësim përdorimi i platformave elektronike?

---

9. Sa ju ndihmojnë platformat elektronike të bashkëpunoni gjatë procesit mësimor?

---

10. A ofron interaktivitet mes juve dhe nxënësve përdorimi i platformave elektronike?

---

11. Sa i ndihmon nxënësit përdorimi i platformave elektronike për t'i përvetësuar më mirë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre?

---

12. A arrijnë rezultate më të mira nxënësit me përdorimin e platformave elektronike?

---

13. Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të platformave elektronike?

---

14. Sa jeni të kënaqur ju dhe nxënësit me përdorimin e platformave elektronike?

---

15. A mund të bëni një krahasim në mes mësimin digjital dhe mësimin tradicional?

---

# SHTOJCA C: TESTIMI I HIPOTEZAVE NË PROGRAMIN SPSS

\*Hipotezat e Hulumtimit.sav [DataSet1] - IBM SPSS Statistics Data Editor

File Edit View Data Transform Analyze Graphs Utilities Extensions Window Help

25: Visible: 2 of 2 Variables

	Hipoteza1	Hipoteza2	var	var	var	var	var	var	var	var	var	var	var	var
1	1	1												
2	1	1												
3	1	1												
4	1	1												
5	1	1												
6	1	1												
7	1	1												
8	1	1												
9	1	1												
10	1	1												
11	1	1												
12	1	1												
13	1	1												
14	1	1												
15	1	1												
16	1	1												
17	1	1												
18	1	1												
19	1	1												
20	1	1												
21	1	1												
22	1	1												
23	1	1												
24	1	1												
25	1	1												
26	1	1												
27	1	1												
28	1	1												
29	1	1												
30	1	1												
31	1	1												
32	1	1												
33	1	1												
34	1	1												
35	1	1												
36	1	2												
37	1	2												
38	1	2												
39	1	2												
40	2	2												
41	2	2												
42	2	2												
43	2	2												
44	2	2												
45	2	2												
46	2	2												
47	2	2												
48	2	2												
49	2	2												
50	2	2												
51	2	2												
52	2	2												
53	2	2												
54	2	2												
55	2	2												
56	2	2												
57	2	2												
58	2	2												
59	2	2												
60	2	2												
61	2	2												
62	2	2												
63	2	2												
64	2	2												
65	2	2												
66	3	2												
67	3	2												
68	3	2												
69	3	2												
70	3	2												

Data View Variable View

IBM SPSS Statistics Processor is ready Unicode:ON



\*Hipotezat e Hulumtimit.sav [DataSet] - IBM SPSS Statistics Data Editor

File Edit View Data Transform Analyze Graphs Utilities Extensions Window Help

25: Visible: 2 of 2 Variables

	Hipoteza1	Hipoteza2	var	var	var	var	var	var	var	var	var	var	var	var	var
71	3	2													
72	3	2													
73	3	2													
74	3	2													
75	3	2													
76	3	3													
77	3	3													
78	3	3													
79	3	3													
80	3	3													
81	3	3													
82	3	3													
83	3	3													
84	3	3													
85	3	3													
86	3	3													
87	3	3													
88	3	3													
89	3	3													
90	3	3													
91	3	3													
92	3	3													
93	3	3													
94	3	3													
95	3	3													
96	3	3													
97	3	4													
98	3	4													
99	3	4													
100	3	4													
101	3	4													
102	3	4													
103	3	4													
104	3	4													
105	3	4													
106	3	4													
107	3	4													
108	3	4													
109	4	4													
110	4	4													
111	4	4													
112	4	4													
113	4	4													
114	4	4													
115	4	4													
116	4	4													
117	4	4													
118	4	4													
119	4	4													
120	4	4													
121	4	4													
122	4	4													
123	4	4													
124	4	4													
125	4	4													
126															
127															
128															
129															
130															
131															
132															
133															
134															
135															
136															
137															
138															
139															
140															

Data View Variable View

IBM SPSS Statistics Processor is ready Unicode:ON

Figura 6. Databaza e të anketuarve për testimin e hipotezave




Figura 7. Rezultatet nga testimi i hipotezave me testin Hi-Katror